

INTERVISTË ME ZYRAFETE KRYEZIU MANAJN

Therandë | Data: 30 qershor, 2022

Kohëzgjatja: 154 minuta

Të pranishëm:

- Zyrafete Kryeziu Manaj (E intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Zyrafete nëse mundeni me u prezantu? Datën e lindjes? Vendin? Diçka për familjen? Prejardhjen?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, faleminderit fillimisht që jemi këtu bashkë. Unë jam Zyrafete Manaj, me mbiemrin e babës Kryeziu. E lindur edhe rritur në Suharekë. Kam lindur në vitin 1958 në ni familje ku nana edhe baba kanë rritë nantë fëmijë, pesë motra dhe katër vllazër. Ni familje, në familje, domethonë kemi pasë ni harmoni të plotë, kemi zhvillu batuta nga më të ndryshmet dhe kemi qenë ni familje jashtëzakonisht e harmonishme në mes vete.

Përkundër asaj vështirësie të jetës që kemi pasë, qoftë nga sistemi i perënduar tashmë, qoftë nga peripetitë e jetës nga më të ndryshmet, ne megjithatë i kemi mbijetu. Dhe them se i kemi mbijetu fuqishëm të gjithë atyre katrahurave të kohës që na kanë përfshi gjatë gjithë jetës. Baba dhe nana ime, unë jom krenare në fakt për prindërit që na kanë lindë dhe na kanë rritë në atë frymë që s’pari ta duam vetëvetën, ta duam atdheun. Dhe kur njeriu e do vetëveten dhe atdheun atëherë osht’ mbi të gjitha ato që, mbi të gjitha ato që i përkasin ni njeriu të suksesshem në jetë.

Baba im ka qenë pak kohë punëtor i fabrikës “Ballkan”. Mirëpo, në atë kohë në vitet e ‘60-ta, sistemi i atëherëshëm i ka bo presione nga më të ndryshmet dhe ka ra në konfrontim me një punëtor të nacionalitetit serb dhe që nga ajo kohë iu ka mohu çdo e drejtë për punë në sistemin e atëherëshëm. Mirëpo, megjithatë ne nuk jemi dorëzua. Nëntë fëmijë thashë paraprakisht kemi qenë, shtatë nga ta jemi rritë, jemi shkolluar në profesione të ndryshme dhe baba me nanën gjithmonë na kanë stimuluar për jetën për me mbri atë që dëshironim. Edhe pse Serbia edhe Jugosllavia e atëherëshme kanë bo ni presion të jashtëzakonshëm mbi familjen, thashë, pra, babën e kanë largu nga puna.

Vllau im profesor i letërsisë shqipe, ka nejt dymdhetë vite mbas diplomimit i papunësuar se ia kanë kufizu të drejtën e punësimit. Nuk e kanë leju, domethonë Komiteti i atëherëshëm që bonte presione të ndryshme ndaj njerëzve që nuk i përshtateshin sistemit. Unë kam qenë e larguar tri herë nga puna. Motrat e mia kanë qenë të larguar disa herë nga shkolla, qoftë nga shkolla e mesme, qoftë nga fakulteti. Dhe, domethonë, na është mohu çdo gjë që i takon ni njeri që të jetë i lirë.

Mirëpo, megjithatë ne kemi punuar, jemi munduar saqë shpesh herë na thonte, na thonin kta “komitetlinjë”¹ dhe policët e asaj... ose ma mirë me thanë milictë e asaj kohe na merrnin sikurse ne e adhuronim Enver Hoxhës, sistemin e Shqipërisë se punonim... jemi rritë dhe jemi shkolluar me punë bujqësore. Nga fruti i punës sonë ne kemi arritë të gjitha ato. Prandaj, mund të them se kemi qenë familje, sa kemi qenë e sakrifikuar nga sistemi. Kemi qenë aq të fortë mbi atë sistem që është munduar ta shuaj të mirën e shqiptarisë.

Anita Susuri: A lidhet ky persekutim i vllaut edhe familjes edhe me ngjarjet që kanë ndodhë gjatë demonstratave të vitit ‘68?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, në fakt baba im ka qenë bartës i flamurit kur Haxhi Bajraktari e pati ngritë flamurin në, këtu në Suharekë në vitin 1968. Pastaj reagoi policia e kohës dhe njerëzit të cilët ishin argat të sistemit të Jugosllavisë dhe e morën flamurin dhe e... si me thanë, e burgosën në ni librari që ka qenë në qendër të qytetit në atë kohë. Babi im me disa shokë të vet shkojnë edhe e thyjnë drynin e asaj librarie, e nxjerrin flamurin dhe për dy orë të tëra e kanë defilu nëpër qytetin e Suharekës. Çka ka qenë karakteristike e asaj dite, sepse ka qenë ditë tregu edhe të gjithë pazarxhinjë e asaj dite e kanë marrë, i kanë lanë gjanat e veta në pazarin, në tregun e Suharekës edhe iu kanë bashkangjitë demonstratës së asaj kohe.

Ka qenë, unë kam qenë në moshën nantë-dhjetë vjeçare kur ka ndodhë ngjarja. Si fëmijë, edhe pse nuk e kam ditë unë randësinë, se ni fmi nuk e ka edhe shumë shumë të kuartë rëndësinë, peshën e asaj se çka ka ndodhur. Mirëpo, me zhvillimin e kohës, me bisedat e babës që na mbante gjithë herë rreth kaftorrit të ndezur ditëve të dimrit dhe na tregonte histori të ndryshme për heronjtë, për historinë e popullit tonë. Atëherë ne jemi rritë dhe jemi burgosë me dashuri për atdheun.

Më kujtohet si fëmijë atëherë kanë nejt shumë nëpër oda edhe odat kanë qenë ni lloj kuvendi për kohën. E di që baba më shtinte t’i mësoja poezitë e Naim Frashërit dhe kur kishte burra në odë më ftonte mu edhe ma caktonte, “Ti do ta msojsh këtë poezi”, domethonë për qikaq ditë. Unë e mësoja poezinë, e merrte e inçizonte. E kemi pasë ni kasetofon të kohës atëherë nëpër ato trakat ju thonim, inçizonte edhe shpesh herë kur unë nuk isha prezente se ata shëtiteshin nga ni odë në odën tjetër.

Kur rrinin në oda të tjera, babi e merrte atë kasetofonin me veti dhe ju lshonte burrave në atë kohë poezitë e mia ose kur ishim në odën tonë ai me ftonte mu aty në atë kuvendin e burrave (buzëqesh,) ta quj ashtu. Dhe unë si fëmi impresionohesha dhe ndihesha shumë e lumtur që mund ta bëj një gjë të tillë, sepse fëmiu gjithmonë merr fuqinë nga të mdhejtë. Varet se si ata ia trasojnë rrugën për jetë. Kështu që, jemi rritë me ndjenja të tilla.

Anita Susuri: E ju në familje keni pasë këto libra? Keni mbajtë?

¹ Punonjësit ose anëtarët e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kosovës.

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po. Në fakt babi edhe vite ma vonë osht' marrë edhe nëpër biseda informative. Bile e di shumë mirë se ka qenë ni UDB-ash² i asaj kohe, Vesel Krasniqi, i cili e pat marrë babën gjatë viteve, pas viteve të '68-ta nëpër informata të ndryshme, nëpër intervista të ndryshme, nëpër... me nifarë mënyre i kanë bërë luftë psikologjike, por jo vetëm psikologjike po edhe torturë fizike për të dhanë emra, për të treguar aktivitetin e tij, e të tjera, të tjera.

Pastaj kur rash unë në burg në vitin '82, 1982 pas demonstratave kur u zhvilluan në Prishtinë, i njejt... ndër shumë inspektorë të sigurimit të asaj kohe ishte edhe ky pikërisht edhe e dinte shumë mirë rrjedhën e familjes time, burimin e gjithë asaj veprimtarie, për shkak se ai ka qenë vazhdimisht i interesuar dhe ka vëzhguar familjen në procese të ndryshme të kohës.

Anita Susuri: E babai juj a ka qenë edhe ai i organizum ndonjëherë në ndonjë rrjet ilegal apo veç ka qenë...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Nuk muj me thanë që ka qenë i organizuar ose i futur në ndonjë rrjet. Mirëpo, ka qenë, si me thanë, bartës i propagandës. Sepse Kosova ka qenë e robëruar dhe për ta liruar Kosovën, Kosova të jetë e lirë duhet të bëhet një revolucion, ni ndryshim i asaj kohe. Baba ka punuar shumë ngusht me Nezir Kuqin, me Destan Bajraktarin, me Adem Demaçin, me Nezir Kuqin veç e thashë dhe shumë burra të Suharekës dhe jo vetëm të Suharekës. Por që e kanë gjetë atë frymën e përbashkët dhe kanë zhvillu ide të ndryshme për të bërë propagandë në popull, sepse në atë kohë është dashtë të bëhet ni propagandë për lirinë e ardhut, për çlirimin e atdheut. Sepse jo i tërë populli e ka ditë ose e ka kuptuar që ne vërtetë jemi edhe jetojmë nën robninë e Jugosllavisë.

Ne e dimë shumë mirë se në atë kohë Jugosllavia ka pasë ni propagandë të hatashme për ta bindë edhe botën, por për ta bindë edhe popullin që jetonte brenda Jugosllavisë, sepse na jetojmë në një liri, ne i kemi të gjitha të drejtat e barabarta si kombe edhe si popull. Mirëpo, në fakt ajo nuk ka ekzistue, nuk ka qenë e vërtetë për popullin shqiptar.

Anita Susuri: Po ktu deshta edhe me u lidh me juve, me ju pytë te baba si osht' zhvillu ajo ndjenja? A ka qenë edhe, për shembull, babai i tij, gjyshi juj apo ndoshta...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, po. Sigurisht që babai im ka marrë domethonë atë nektarin e atdhedashurisë nga babai i tij, nga të parët e tij. Dhe kjo është përcjellë pastaj brez pas brezi te babi, babi e ka përcjellë te ne, ne mundohemi ta përcjellim te fëmijtë tanë. Edhe pse situata në Kosovë tash është ndryshe. Shpesh herë kur unë bisedoj me fëmijtë e mi ose fëmijtë e fëmive të mi për disa gjëra për ta është edhe ni si lloj, abstrakte, se si ka mund të ndodhin gjëra të tilla. Si ka mujt, për shembull ni shtet të jetë shtet agresiv ndaj popullit që atëherë aludohej se jetonim në një Jugosllavi të përbashkët dhe të gjithë kemi të drejta të barabarta.

² Srb.: *Uprava državne bezbednosti (UDB)* - Drejtoria e Sigurisë Shtetërore. UDB-ash ishte mënyrë për t'iu referuar punonjësve dhe hetuesve të drejtorisë së sigurimit.

Unë shpesh herë them se duhet shumë, secili nga ne për të dhënë jo vetëm intervista, por për të lënë edhe shënime me shkrim në forma nga më të ndryshmet për ta kuptu edhe gjeneratat e reja se liria e Kosovës nuk osht' fituar lehtë. Ka qenë ni punë jashtëzakonisht e rëndë, ni sakrificë për popullin për të ardhë deri këtu. Ne e kemi pasë si aktivista të asaj kohe, e kemi pasë të vështirë edhe nga vet bashkëatdhetarët tanë, sepse ni pjesë dërmuese e asaj kohe kanë qenë mbështetës të Jugosllavisë dhe ka qenë vështirë me i bindë se kjo nuk është rruga e drejtë për Kosovën, për popullin e saj.

Duhet një rrugë tjetër, duhet një aktivitet krejt ndryshe për të ardhë deri te ajo që ne ta mësonim gjuhën tonë, historinë tonë, që historinë tonë ta shkrujmë ne vet, historianët tonë. Dhe jo historia të na shkruhej në Beograd dhe të na vijë e servuar në Kosovë. Pastaj kanë qenë të anatemuar shumë shkrimtarë tonë, krijues tonë, njerëz që e kanë dashtë atdheun tonë. Para viteve '68-ta ka qenë, e kemi pasë të ndaluar flamurin, e kemi pasë të ndaluar të drejtën e historisë tonë. Nëpër shkolla nuk osht', nuk osht' ligjëruar para nxënësve, para studentëve se kush jemi ne. Çdo gjë e lidhnin me burimin, gjoja se ne kemi lidhje të ngushta me popujt sllav, me popujt tjerë që kanë jetue në ish Jugosllavi, gjë që nuk ka qenë e vërtetë.

Anita Susuri: Po që përmendet, domethonë familjen e juaj që ka qenë atdhedashëse, a ka qenë edhe rrethi juaj i tillë apo?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Jo i gjithë rrethi, jo i gjithë rrethi. Unë e potencova, po të jap vetëm ni shembull. Mua më arrestuan nga procesi mësimor në vitin 1982 edhe në kohën kur më arrestuan dhe kur e përfundova unë burgun, unë i shisha kolegë të mi, njerëz që nëse më shihnin që shkoja në drejtimin e tyre, e kisha rrugën që më duhej të bëja, e shihja që kolegët e mi e thynin rrugën dhe kalonin në anën tjetër. Disa kushëri të mi, disa kojshi të mi të cilët kanë qenë, nuk kanë qenë të vendosur. Nuk kanë qenë statik ndaj asaj që ne duhet ta dojmë atdheun tonë vërtetë siç duhej ta donim, mirëpo ishin... ose e ruanin pozitën të cilat i kanë pasë që i ka dhanë sistemi i atëhershëm ose nuk kanë dashtë të sakrifikohen ose... mendime nga më të ndryshmet.

Mirëpo, fatmirësisht, me kalimin e kohëve, me rrjetet e kohës, me grupacionet ilegale, me literaturë të ndryshme që kemi shpërndarë, me afishe të ndryshme, parulla të ndryshme ma në fund janë vetëdijësuar po them. Se pjesa dërmuese e gjithë atyre dhe pastaj me ardhjen e UÇK-së dhe me ushtrinë tonë e kanë kuptu rrënjësisht se paskan qenë, paska qenë e vërtetë ajo periudhë kohe për të cilën ne kemi sakrifikuar shumë, kemi dhënë shumë. Kemi dhënë, kemi dhënë domethonë jetën e kanë dhanë njerëzit, ju kemi nënshtrur torturave nga më të ndryshmet, fizike, psiqike, burgosje të gjitha ato. Por, fatmirësisht e arritëm atë çfarë ne, për çfarë ne jemi sakrifikuar dhe jemi munduar gjatë gjithë jetës.

Anita Susuri: Po du pak me u kthy ma mrapa pastaj me vazhdu te aktiviteti juj. Më tregutë për babën edhe që faktikisht prej tij e keni marrë atë, ua ka mbjellë atë ndjenjën kombëtare. Po si ka qenë nana juj? Domethonë, nantë fëmijë...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Faleminderit shumë për pyetjen. Nëna ime ka qenë ni nanë e pashkolluar, por brenda saj ka qenë ni universitet i tërë, ni fakultet i tërë. Pse po e them këtë? Po e them se nëna ime vetëm mundin që e ka bërë për rritjen tonë, ajo na ka brumosë me atë dashurinë për atdheun edhe për njeriun në mënyrën ma të sinqertë. Pastaj, gjatë viteve të '90-ta, po kaloj tash te kto vitet ma të fundme, nëna ime ka qenë pjesëmarrëse e rregullt e demonstratave edhe çka ka qenë karakteristike, sepse atëherë policia gjunte gaz me...

Anita Susuri: Lotsjellës.

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, lotsjellës a po si janë qujtur.

Anita Susuri: Gaz lotsjellës.

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, edhe nëna ime siç ka qenë tradita e nënave tona atëherë me ato dimijat, shkonte edhe izolonte gazin, atë lotsjellsin me dimija edhe kur e pa turma e demonstruesve se si vepronte nana atëherë e vraponin ne që ishim rreth saj që e shihnim ata edhe na jipte ni kurajo të jashtëzakonshme. Besom ka qenë ni ndjenjë jo që bonim demonstratat dhe ishte e rrezikuar jeta jonë, po na u doke vetja që shkonim në ndonjë dasmë apo në ndonjë aheng. Ishte ajo fryma e atdhedashurisë aq e lartë, aq e dinjitoze, saqë secili nuk mendonte për vetën e vet por mendonte për tjetrin që e kishte afër. Kështu që, nana ka qenë shtylla kryesore për ta mbajtur, për ta mbajtur familjen grusht dhe për ta avancuar më tutje. Për të gjitha kto të arritura që i kemi i kemi pasë më pastaj. Unë jam shumë falënderuese ndaj nënës sime për kontributin që e ka dhanë ndaj neve, por jo vetëm ndaj neve.

Në shtëpinë tonë para tri-katër dite unë pata kontakte me disa shokë të kohës edhe shoqe, bile njëri prej tyre tha, “Bacit Rrahman ia kemi”, tha, “borxh me ia ble do shilte”, atëherë që u përdorshin për oda, “sepse”, tha, “ia kemi shky”, tha, “t’u shku atje t’u majtë ato mbledhjet e ndryshme”. Pastaj, kur u mbyllën kto shkollat tona që na i mbylli Serbia, vëllau im i pat marrë tanë inventarin e librave të tij, gjithë neve tjerve sepse unë isha e martuar, motra tjetër ishte martuar. I kombinum ato libra që i kishim në shpi edhe i vendosëm në odën e tyre dhe për qytetin e Suharekës u bo ni bibliotekë. Shkonin nxansat aty për literaturë që u nevojitej për shkollimin i merrnin. Vet i merrnin, vet i kthenin, domethonë ka qenë ni vetorganizimi i jashtëzakonshëm për kohën.

Nana kujdesej gjithmonë, nana... unë i kam pasë edhe dy nusët e vllazërve ma të mdhej edhe ato çdo herë janë kujdesë, domethonë për çdo gjë që është nevojitë. Për kohën kanë qenë gjithmonë të gatshme edhe pionere për aktivitetin që zhvillohej në vazhdimësi.

Anita Susuri: Cili fëmi me radhë keni qenë ju?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Unë kom qenë fëmiju i pestë me radhë. Dy vëllezër edhe dy motra kanë qenë ma të mdhej se unë. Unë kam qenë fëmiju i pestë me radhë, fëmiju aty kah mesi (qeshë).

Anita Susuri: E deshta me ju pytë, si e kujtoni Suharekën në atë kohë? Qysh ka qenë infrastruktura e qytetit?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Suhareka ka qenë, mund të them, që ka qenë ni fshat pak ma i madh sesa fshatet tjera që i ka përreth. Ka qenë ni infrastrukturë, po edhe nuk ka pasë edhe aq infratrakturë me thënë të drejtën. E kujtoj ka qenë ni sallë e filmit në atë kohë dhe shkolla fillore ka qenë ni ndërtesë e vjetër. Në atë shkollë pastaj në vitet, pas viteve të '60-ta, nuk e di saktësisht kur u hap edhe ni degë e Shkollës Normale të Prizrenit aty. Mirëpo, ma vonë pastaj është ndërtu shkolla edhe sot që përdoret, "7 marsi", ni shkollë ma e madhe.

Unë kom pasë fatin aty ta kryj shkollën fillore. Atëherë është thirrë, "Vllaznim-Bashkimi", sepse nën parullën e vllaznim-bashkimit janë bërë shumë gjëra. Çka ka pasë tjetër? Nuk ka pasë, domethonë, ndonjë infrastrukturë për të dëshiruar, sepse nuk ka... Jugosllavia nuk ka qyrë për me zhvilluar Kosovën me bo ni kopsht me lule siç pretendonte ose siç fliste atëherë nën parullën e asaj, të asaj parulle të vllaznim-bashkimit. Nuk ka qenë ashtu siç ka propagandue në Evropë Tito në atë kohë e njerëzit e tjerë rreth tij që kanë qenë.

Anita Susuri: Kjo shkolla që përmendet, "7 marsi", a osht' tash si objekt muze?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Jo, kjo është shkolla që është afër saj. Mirëpo, ajo është shkolla e parë që është muzeu tash...

Anita Susuri: Juve s'ju ka ra aty...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po unë kom punu masnej si msuse aty se deri vonë ka qenë ajo aty, kam punu në shkollën "7 marsi" tash, se atëherë, "Vllaznim-Bashkimi", ka qenë. Edhe vonë mas luftës është bo ajo, është bo muze, është shndërruar në muze. Eh kështu ka qenë, por ka qenë fëmijëria jonë, sa ka qenë e vështirë, aq ka qenë e këndshme. Ka qenë ni fëmijëri që ndoshta ni pjesë dërmuese e kohës tonë është marrë me bujqësi, siç thashë ma herët. Mirëpo, ka qenë ajo, na ka mbajtë ajo dëshira për punë, për punën vetanake, për të jetuar nga duart tona, nga mudi ynë dhe për të avancuar në karrierë nga mudi jonë. Këto na kanë majtë.

Kemi qenë jashtëzakonisht entuziastë, kemi qenë të lumtur po them edhe pse i kemi pasë të gjitha ato presione. Kemi pasë bastisje nga më të ndryshmet në familjen tonë. Jo, po thom, me dhjetra herë po

shumë shumë ma shumë se dhjetra herë kemi pasë. Vinin në ortë e hershme të mëngjesit UDB-a e asaj kohe, bastiste, trazonte fëmijtë, neve si fëmi, baba domethonë gjatë asaj kohe kur osht' marrë me aktivitetin e vet. Po edhe kur ne jemi rritur edhe ka pasë fëmijtë e vllazërve që kanë qenë fëmi të vegjël në ditë të acarta, dimrit vinin në ora tre, katër të mëngjesit të na qitnin jashtë, thastë e millit i shkynin. Çdo gjë që u dilte përpara se dëshironin me patjetër të gjenin diçka për të na thanë që ju jeni kta dhe ju po veproni kështu ose ashtu.

Anita Susuri: Nuk kanë gjetë kurgjo?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Ne kemi qenë shumë të kujdesshëm në këtë aspekt dhe e kemi ditë, domethonë, mënyrën se si ata vepronin edhe kemi qenë jashtëzakonisht të kujdesshëm.

Anita Susuri: E që e përmendët ktu sallën e filmave, qysh ka qenë jeta kulturore? A keni përcjellë filma?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, edhe pse presioni ka qenë i atillë që të, jeta kulturore gjithmonë të jetë e varun nga sistemi i kohës. Megjithatë, në kuadër të Rinisë së Komunës së Suharekës është bërë ni zhvillim i hatashëm qoftë me orë letrare, qoftë me aktivitete të ndryshme kulturore. "Jehona" e Suharekës në ato vite, vite të '70-ta ka qenë ni shoqëri kulturore artistike që e ka mbajtur, domethonë gjallë jo vetëm jetën kulturore në Suharekë, por në Kosovë dhe përtej saj. Aty, domethonë është zhvillu kangë nga më të ndryshmet që kanë bërë përshtypje të mirë në popullatë.

Pastaj, kanë qenë klubet e basketbollit. Unë njëherit kam qenë edhe basketbolliste e qytetit të Suharekës e më pastaj veç e kam studiue edukatën fizike. Ka qenë klubi basketbollistik "Ylli" ku është përfaqësua edhe nga djemtë edhe nga vajzat e qytetit tonë. Kemi zhvillu ni aktivitet disa vjeçar, derisa unë kam ra në burg. Pastaj kanë vazhdu shoqet e mia. Mirëpo, unë nuk kom pasë mundësi sepse nuk më është lejuar pastaj, sepse më është ndërpre çdo gja, çdo aktivitet. Nuk më lejonin, m'i mbyllnin dyert. Por, jam krenare me punën e vajzave të komunës sime sepse kemi thye barriera të ndryshme.

Vitet e ma hershme kanë qenë të rënda, mendohej që vajzat, gratë shqiptare të rrinin në atë vakumin e viteve paraprake të mahershme. Të mos shkolloheshin, të izoloheheshin në nifarë mënyre, mirëpo ne kemi bo përpjekje çdo herë e më tepër që vajza të shkollohej. Grave shqiptare t'ju jipet liria e plotë, të avancoheshin në shoqëri. Vetëm në këtë mënyrë kemi arritë... edhe pse edhe sot e kësaj dite lë për të dëshiruar roli i gruas në shoqëri në Kosovë. Unë jetoj në Suedi dhe i shoh dallimet, domethonë. E shoh çfarë vendi i jipet gruas në Suedi dhe e shoh në Kosovë.

Në Kosovë shpesh herë grave dhe vajzave tona u japin pozita politike vetëm sa për t'i përmbush ato kuotat politike, por jo të vlerësojnë tamam tamam siç duhet rolin e gruas. E kjo është që brezat e rinj, po edhe ne pse jo, po sidomos brezat e rinj të përpiqen që vajzat dhe gratë tona ta marrin rolin në shoqëri ashtu siç e meritojnë siç duhet të jenë. Kështu.

Anita Susuri: E deshta me ju pytë për kto ngjarjet kulturore, sportive që i përmendët. Sa ka pasë pjesëmarrje edhe a ju kujtohet ndonjë rast i veçantë diçka kur ka pasë?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Osh! Interesant, tash bile pjesëmarrja e shikuesve kur zhvillohen ato ndeshjet them se nuk ka qenë aq sa ka qenë në atë kohë. Ne nuk kemi pasë palestra sportive, nuk kemi pasë salla sportive nëpër poligona të hapura i kemi mbajtur turniret tona, lojnat tona. Mirëpo, gjithë rinia e qytetit dhe jo vetëm e qytetit kur e zhvillonim ndeshjet në basketboll vinin dhe mbushej rreth poligonit sportiv. Aty ka pasë me dhjetëra e dhjetëra shikues që na përkrahnin, që na stimulonin për lojën, për fitoret tona. Kemi pasë, kemi arritë deri në ligën e dytë të Jugosllavisë në atë kohë në basketboll. Domethonë, kemi pasë suksese të mira.

Unë thashë se kemi jetu nga puna që kemi bërë në bujqësi, sepse na janë mbyllur të gjitha rrugtë që të punonim në institucionet e shtetit të asaj kohe. Unë kur... ditëve të vikendit janë zhvillu lojnat në atë kohë zakonisht edhe shkoja paradite punoja në arë, pasdite babi më thonte, “E qitash...” dy orë maksimumi para se të fillonte ndeshja ose tri unë shkoja në shpi pastroheshja, i merrja çantën time dhe gjërat tjera që më duheshin për lojë dhe shkoja.

Vetëm në atë mnyrë kemi mujtë me mbijetu, sepse përndryshe nuk kemi pasë alternativa tjera. Domethonë, unë prej punës fizike shkoja e vazhdoja aktivitetin tim sportiv. Ka qenë ni, sot me i thanë rinisë së sotshme duket ni abstraksion për ta edhe s’e di a do ta besonin këtë. Mirëpo, e vërteta ka qenë e tillë dhe kështu kemi vepru.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Pas shkollës të mesme keni fillu m’u marrë me aktivitete?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, po, që nga shkolla fillore. Në shkollën e mesme profesori Ramadan Shala në vitin ‘78-të më duket, ‘79 është themeluar klubi i parë i basketbollit në qytetin tonë dhe fillimisht kanë shku me aktivitete vetëm të djemve. Pastaj, pas disa viteve, dy apo tri viteve se tash nuk më kujtohet saktësisht është themelu edhe ekipi i vajzave të qytetit. Edhe jam shumë falënderues, mirënjohëse jo vetëm unë po edhe shoqet e mija, sepse Ramadan Shala ka qenë ni profesor që na ka dhanë mundësi të merremi me këtë sport dhe ka qenë ni shtyllë kryesore, domethonë e aktiviteteve jo vetëm sportive por edhe të teatrit të qytetit edhe të orëve letrare që janë mbajtur.

Ai ka qenë profesori i letërsisë shqipe. Ka qenë njëri ndër profesorët e parë të komunës tonë. Tash është në moshën e penzionit, në moshë jashtëzakonisht të shtyer. Mirëpo, ka qenë ithtar i gjithë ktyre gjërave dhe na ka mundësue domethonë. Pastaj, normal që me zhvillimin, me ardhjen e gjeneratave të reja kanë vazhdu edhe aktivitetët tjerë. Domethonë, sot ekipi i “Yllit” është kampion në Kosovë dhe

ekipi i “Ballkanit” të Suharekës është kampion. Suhareka është kampione dhe jam shumë e lumtur që i takoj këtij qyteti (buzëqesh).

Anita Susuri: Po, po më intereson atëherë me ekipin, a keni udhëtu diku për ndeshje?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, po. Atëherë organizoheshim, kemi pasë ni minibus edhe udhëtonim nëpër qytete të ndryshme të Suharekës, të Kosovës po mendoj, dhe po kemi udhëtu. Atëherë janë zhvillu nëpër të gjitha qytetet. Peja ka pasë ekip të vetin, Gjakova, Gjilani, Leposaviqi. Kemi shku edhe në pjesën tjetër të Kosovës andej dhe kemi zhvilluar, kemi zhvillu garat tona. Pastaj, kemi pasur, kemi qenë në Ohër, në disa qytete. Unë kom qenë edhe në kuadër të universitetit kom marrë pjesë në universiada të ndryshme. Bile vlen të theksohet se në kuadër të universiadës kam zanë vendin e dytë në skijim në vitin 1979 ka qenë viti. Kështu që, kom qenë jashtëzakonisht aktive në mënyra dhe forma të ndryshme.

Anita Susuri: Ishit t’u bisedu për aktivitetin sportiv edhe më tregutë që keni udhëtu nëpër vende të ndryshme. Po po më intereson kur u formu ky klubi për vajza...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po.

Anita Susuri: A ka pasë ndonjë paragjykim prej rrethit? Qysh u pritë?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po ka pasën. Thashë që në secilën periudhë të kohës ti nuk mund t’i gjejsh të gjithë ose të jetë i gjithë populli adhures i ni gjëje. Ne, për shembull, atëherë si sportistë u dashtë të vishnim uniformën sportive e sene. Ka pasë, domethonë pleq, individë, ndoshta edhe gra apo burra të moshës ndoshta edhe ma të re, por që ne si vajza të kohës nuk iu ka pëlqy mënyra si kemi dalë ne, a din. Mirëpo, për neve ka qenë me rëndësi të thenim barrierat e kohës, të avancoheshim në shoqëri edhe pikërisht, ndoshta ka qenë shumë e mirë t’i tregonim edhe sistemit edhe Jugosllavisë së atëhershme se nuk jemi ni popull që, siç na quanin ata lavatriqe, nanat tona se dijnë vetëm të lindin fëmijë edhe nuk janë të gatshme apo nuk janë të zonjat për gjëra të tjera.

Ne përkundër gjithë atyre vështirësive kemi arritë të çajmë këto barrikada, në të gjitha sferat e jetës qoftë sportive, qoftë kulturore, qoftë të asaj shkollimit të vajzave të asaj kohe. Bile muj me thanë që vitet e ‘70-a njihen si një, si një avancim, si një shkollim që është përfshi gjinia femërore në mënyrën masovike. E kanë kuptue që pa zhvillimin edhe pa avancimin e gruas apo vajzës shqiptare edhe ne si komb do të jeshim mangu dhe nuk do ta mund ta arrijmë atë piedestalin e duhur nëse gruaja shqiptare nuk do të jetë e shkolluar. Edhe jemi përpjekur edhe besoj që deri diku ia kemi arritë qëllimit.

Anita Susuri: Shkollën e mesme e keni vazhdu ktu në Suharekë apo?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, shkollën e mesme. Shkollën fillore edhe shkollën e mesme e kom mbaru ktu në Suharekë. E më pastaj jam regjistru në Fakultetin e Edukatës Fizike dhe e kam kry fakultetin në Prishtinë.

Anita Susuri: E gjatë shkollimit të mesëm, çfarë arsimtarë ose profesorë keni pasë? Edhe sa ka qenë e lejume, për shembull historia ose letërsia shqipe me u mësu?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Unë kujtoj i kemi pasë disa profesorë të cilët kanë qenë, mund të them, se atëdhetar të devotshëm. Bajram Kurti ka qenë, Ramadan Shala siç e përmenda, Xheladin Shala ka qenë profesor i historisë edhe ka qenë kujdestar i klasës time për dy vite. Që nga shkolla e mesme neve na është, përveç anës familjare, na është rrënjosur ajo atdhedashuria, sepse ata ligjëronin me pijetet për njerëzit që kanë dhanë dhe kontribuar nëpër periudha të ndryshme të kohës në histori. Mund të them se ne si të rinjë që ishim në atë kohë, veç atëherë filluam aktivitetin tonë me ndonji parollë, me ndonji, me kto aktivitetet letrare që i zhvillonim, shkruanim poezi të ndryshme, i dedikonim Skënderbeut, heronjëve tanë edhe kjo ka qenë aty ato dromcat e para të cilat ose të them ato shkëndijat e para të cilat kanë hy brenda nesh, për të avancua pastaj në mënyra edhe më voluminoze edhe të parreshtura. Pastaj në studime e kështu me radhë.

Anita Susuri: E ju gjatë kohës, po thoni, shkollës të mesme veç keni fillu me zhvillu qato, me thanë aktivitetin?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po.

Anita Susuri: Po nuk ka qenë kontakti me ilegale?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Jo, s'ka qenë, ka qenë ma vonë. Personalisht une jo, të tjerët ndoshta edhe kanë mund të kenë. Mirëpo, aktiviteti im ilegal, të them të quaj ashtu, ka filluar në studime. Në studime jam njoftë me grupacione të ndryshme ilegale, kam qenë në kontakt me Qefserën Malën, Teuta Hadrin, Teuta Bekteshin, Lumnije Musën, me Xhevahire Rrahmanin. Pastaj jam njoftë me ni grup vajzash edhe aktiviteti... vajza të cilat kanë kriju aktivitet, kanë kryer aktivitet edhe në burg kur kam ra atje me shumë, Hidajete Osmanin edhe shumë vajza tjera.

Mirëpo, për t'ia dhanë atë jehonën e madhe edhe për ta bërë atë revolucionin në Kosovë kanë qenë vitet e... fundvitet e '70-ës dhe fillimi i viteve '80-a. Aty ka qenë... studentët kanë zhvillu aktivitete nga më të ndryshmet, qoftë ilegale, qoftë dhe legale. Kur them legale, çka kanë mund të bëjnë? Ne nëpër konvikte lshonim muzikë të Arif Vladit, të Fatime Sokolit, të artistëve shqiptarë të ndryshëm me zë të madh që të dëgjohej jo vetëm brenda territorit të konvikteve, por edhe nëpër ato lagje ku konviktet e studentëve në atë kohë ishin të rrethuar.

Pikërisht këto gjëra në pamjen e parë duken gjëra të imta dhe nashta sekondare, mirëpo megjithatë këto e kanë bo atë, si me thanë, atë, e kanë mbjellë atë ndjenjën që qenka diçka që duhet të shofin ndoshta pak ma ndryshe përceptimin e të gjitha atyre që ndodheshin në atë kohë në Kosovë. Pastaj, në jetën ilegale, kuptohet grupet e ndryshme kanë vepru. Unë personalisht, për shembull kam punu edhe kam vepru shumë me grupin... nuk kam qenë anëtare e ndonji grupi, por kam qenë ndërlidhëse e disa grupeve.

Herë pas here kam punu me ni grup tjetër në shpërndarjen e pamfletëve. Me grupin tjetër ndoshta, me individë të grupeve të tjera kemi shkru disa parolla. Kemi ardhë kemi shpërnda pamflete të ndryshme në territore, në qytete të ndryshme të Kosovës. Bile du me theksue, pasi... para se me u burgosë une kemi shpërndarë me motrat e mija, me Qefserin, me disa vajza të kohës nëpër, në të njejtën ditë në disa qytete ma të mdhaja të Kosovës të njejtin pamfletë, me të njejtën thirrje që populli i Kosovës të zgjohet, të thotë fjalën e vet dhe të vijë deri te demonstratat e protestat e ndryshme. Këto kanë qenë ato gjëra që ne jemi mundua ta mbajmë frymën e atdhedashurisë gjallë dhe ta mbjellim te të tjerët të cilët me vështirësi e kanë kuptu që Kosova duhet të frymoj ndryshe.

Anita Susuri: Ju '78-ën apo në cilin vit jeni ardhë në Prishtinë?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Unë kam qenë '78, '79 vitin e parë që kam qenë studente në Prishtinë.

Anita Susuri: Edhe keni qenë e vendosur në konvikt?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Kom qenë e vendosur në konvikt. Edhe me të thanë të drejtën që më tha për ta evoku ndonjë kujtim, në konvikt kom qenë me Kadën Berishën, Lira Kuqin edhe Shpresa Elshanin. Edhe ajo dhoma jonë e konviktit u bo si një dhomë kuvendi. Mblidheshim studentet aty edhe shfaqnim mendimet tona si t'ia bëjmë, si të veprojmë. Kemi shpërnda literaturë të ndryshme të kohës, libri i Adem Demaçit, "Gjarpërinjtë e gjakut", ka qenë ni libër që është përcjellë nga dora në dorë. Pastaj ka pasë libra të ndryshëm, literaturë të ndryshme nga Shqipëria që vinte.

Ato jemi munduar që t'i bartim nëpër rrjetin studentor dhe po them se ato, ajo literaturë që na binte në dorë është në shumicën dërmuese të studentëve ka depërtue. Këto gjëra e kanë vetëdijësuar popullin tonë, kjo literaturë, ky organizim, këto parolla, këto pamflete, këto afishe e kanë vetëdijësue edhe atë të pavetëdijësueshmin, se vërtetë ne qenkemi robëruar edhe qenkemi duke jetuar në një shtet që nuk na takon neve.

Anita Susuri: Po fillimisht qysh e keni fitu besimin ju ndërmjet vete shoqet që keni bisedu gjana të tilla?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po (qeshë) është interesant. Po ta rrëfej një kujtim që, sesi jam taku me shoqen time ma të ngushtë, Qefsere Malën. Isha në konvikt dhe një shoqe nga Ferizaji, Rrushe

Ramadani, ishte studente e mjekësisë dhe e kishim ne dhomat afër dhe sikur vajza që ishim ne kontaktojshim “Mirëmëngjes!” “Mirëdita!” Dilshim në banjo i pastrojshim sytë ose nëpër koridore. Dhe aty me ndonji fjalë që e lshonin për njëra-tjetrën ishim në gjendje me kuptue mentalitetin ose atë shkëndijen sesi gjatë bisedave të ndryshme e blenim njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë i ofroheshim njëra tjetrës për të ardhë deri te ni vendim ose te ni mendim i përbashkët. Në këtë mënyrë.

Po ta tregoj edhe ni rast tjetër me Lumnije Musën, ato, ajo ishte me Xhanije Berishën në një dhomë, unë isha me Qefsere Malën dhe dhomës tonë i ishin prishë siguresat dhe nuk kishim rrymë aty. Unë shkoj e marrë siguresën e dhomës së atyne dhe e ndroj e vendosi tek dhoma ime dhe atë siguresën e prisht e vendosi te dhoma e atyre. Tash kur u ndal rryma në dhomën e tyre, del Lumnije Musa nga dhoma thotë, “Oj çikë, ku pate ti të drejtë me e prek rrymën?” Thom, “Jo, nuk di çka u bo edhe te na nuk kemi rrymë dhe për atë arsye jom ktu”. Unë e kuptova që ishte gjakovare, sepse nga e folmja e saj e kuptova që ishte gjakovare. Nga ajo, si me thënë, konfrontimi me fjalë pak si të ashpëra, arritëm ta zbutim tonalitetin dhe të lidhemi një shoqëri të fortë. Sot e asaj dite jam në kontakt me të dhe kemi ba, kemi kryer edhe disa aktivitete të përbashkëta. Këto kanë qenë ato.

Nuk e di as vet sesi vinin në kontakt shoqja me shoqen. Unë, për shembull disa shoqe të mija, vendase të mija i njoftova me shoqe për të cilat kisha besim që mund të flisnin, që mund të vepronim një gjë të përbashkët. Mirëpo është dashtë ni konspiracion i hatashëm, sepse kemi pasë, ka pasë njerëz që infiltrroheshin në mënyra të ndryshme dhe vinte deri te rreziku, deri te burgosja, deri te marrja në pyetje, te rreziku edhe fizik edhe psikik. Kështu që, është dashtë ni konspiracioni hatashëm.

Anita Susuri: Qysh ka ndodhë ai kontakti i parë me ilegale që ju e keni marrë vesh që po ekzistojka ni rreth i tillë?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, shiqo unë thashë ni, për shembull kur vdiq, kur i vraftën vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zekën, unë udhëtoja për... me Qefsere Malën dhe Nuhi Berishën jom konë në familjen e Kadri Zekës për ngushëllime. Dhe e kujtoj, ishim në autobus dhe Nuhiu po na thotë edhe mu edhe Qefserit thotë, “Do ta krijojmë ni treshe, po do të m’i jipni emrat e juj ilegal”, a din. Mbas gjithë asaj që e kuptum që kush jemi na, kush është ai edhe vinim deri te ni përfundim që ne mund të bënim diçka të përbashkët. Unë tash, pasi u inkadroshim në ni treshe, unë, për shembull vija në Suharekë dhe e formoja treshën time. Në treshën time kemi bashkëvepru me motrën time të ndjerë, Myrvete Kryeziu, me Naime Hoxhën.

Përveç asajna, i kom pasë vendaset e mija, Kada Berisha, Lira Kuqin, me kto vepronim diçka tjetër. Me ato tjerat e bonim ni aktivitet tjetër. Me Qefserën, me Shyretën Malën e bonim ni aktivitet tjetër. Me, për shembull, Lumnije Musën, Teuta Hadrin bënim ni aktivitet tjetër. Nuk ka qenë, domethënë po koncentrohemi me ni aktivitet dhe me të gjitha ta bënim ni aktivitet të tillë. Aktivitetet kanë qenë nga më të ndryshmet. Me secilin person që kishim kontakte, fillimisht normal që është dashtë ta dinim

kush janë, prej çfarë familje rrjedhin, çfarë idesh kanë, gjitha kto edhe normal që pa e studiu mirë e mirë se kush ishin na nuk guxonim të futeshim në aventura të lehta për të ardhë pastaj te rreziket.

Anita Susuri: E juve pastaj kush ju ka identifikuar si person të besueshëm?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Mas kontaktit, më duket nuk e çova deri në fund atë kujtimin që desha ta evokoj. E mora librin, “Gjarpërinjtë e Gjakut”, nga Rrushë Ramadani apo ia dhashë unë, tash nuk më kujtohet mirë, më duket ia dhashë unë. Ajo e kishte çu te Qefserë Mala, se jetonim në konvikt. Edhe shkoj i thom asaj Rrushes i thom, “Po çka u bo me librin?” Tha, “Ia kom dhanë”, tha, “ni vajzës anena”, tha, “e komunës të Kamenicës”, tha, “do të shkojmë bashkë t’ia marrim”. Edhe unë si sportiste që kam qenë u veshja me ni jakne lëkure, me do farmerka, me do... edhe kur hinëm në dhomë asaj iu doka si ni bandite me thanë, po shprehna kështu (qeshë).

Pijtëm kafe, nejtëm, shkëmbyem disa mendime dhe unë dola, shkova. Ajo i ka thanë Rrushes, “Çka ma prune atë çikë ashtu me atë veshje? Qysh mujte me pru në dhomën time?” Ajo thotë, “Jo, jo”, thotë, “prit prit se librin që ta dhashë unë prej kësaj e kom marrë”, edhe aty filloi. Masanej kontaktojmë në koridore, “Mirëmëngjes, çka bone?” Edhe kështu fillonte ajo kontaktet tona, u afroshim njëra me tjetrën. Edhe ka qenë, ka qenë s’e di, ka qenë, sa ka qenë rrezik aq jemi ndi të plotësuar me veprimtarinë tonë. Jemi ndi si njerëz të mdhaj përbrenda vetës, jo të mdhej me po ose ksi gjëra, mirëpo brenda vetës të plotësuar sepse bënim diçka të mirë për atdheun tonë të robëruar.

Anita Susuri: A ju kujtohet aktiviteti i parë që e keni bo?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Aktiviteti i parë ka qenë shkruanin disa, disa pamflete me dorë, nuk kishim makina shkrimi edhe shkruanim me dorë. Kopjen e asaj pamflete unë e Nuhi Berisha ia kishte dhanë Qefserës, Sali Malës, Bajram Dërmakut edhe unë mora... banonim në atë kohë te, në një banesë private. Ne shkruajtëm aty, se merrnim atë fletën që ishte e formatit A4 e ndanim në katër pjesë dhe e shkruanim tekstin me dorë tonë, me laps të kuqe, e kujtoj edhe ngjyrën e lapsit, me ngjyrë të kuqe.

Unë kur erdha ktu në Suharekë angazhova treshën time që të shkruante. E angazhova vendaset e mija edhe kështu që ato pamfletë u shpërndajtën. Pastaj në konvikte, në oborret e konvikteve të studentëve, në gjimnazin “Jeta e Re” në Gjakovë në një pjesë, në Gjilan janë shpërnda, pastaj në Pejë janë shpërnda. Domethonë, në disa qytete ma të mdhaja të Kosovës dhe është bërë ni bujë domethonë në atë kohë. Sepse të shpërndahen në të njejtën ditë, i njejtë tekst i atyne pamfletëve ka qenë ni gjë shumë me rrezik, shumë... po në të njejtën kohë ka qenë edhe ni punë shumë e mirë sepse shumë njerëz janë vetëdijësu. Ne shkonim edhe nëpër oborret e shtëpive vetëm i futnim ato mbi mure ose nën pragët e dyrëve, gjenim mënyra edhe alternativa nga më të ndryshmet.

Anita Susuri: Ju i keni mbajtur ato të fshehura?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, po.

Anita Susuri: Edhe i keni dhanë...

Zyrafete Kryeziu Manaj: I fshihnim në trup, nëpër çanta, i përzinin me libra të studimeve. Në mënyra ma të ndryshme domethonë kemi vepruar.

Anita Susuri: A jeni frikësu që ndoshta dikush ka me ju identifiku prej personave që ia jepni?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Sigurisht që po. Por ne nuk kemi dhanë në dorë, domethonë, nuk kemi dhanë në dorë. Pjesën, s'paku veprimtarinë që unë e kam zhvillue ka qenë ose nën pragun e dyrëve kemi hedhur ose nëpër bankat shkollore. Për shembull ni aktivitet që kam kry unë me motrën time në Gjimanzin "Jeta e Re", e kemi thy dritaren e shkollës, jemi fut brenda dhe i kemi fut nëpër bankat e nxanësve dhe e kemi kry atë aktivitet. Nëpër lagje të ndryshme të qytetit siç thashë nëpër pragje të dyrëve aty ku kemi mujtë ose mbi mur e kemi hudhur. Në mënyra nga më të ndryshmet. Kemi gjetë mënyra të cilat na kanë konvenu edhe kanë qenë të arritshme nga ana jonë edhe kështu në këtë mënyrë i kemi bërë.

Anita Susuri: E mbledhjet po thoni i keni mbajtë nëpër konvikt, për shembull banesa, shpija të juja?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, po, po. Kemi gjetë... shiqo, ai aktiviteti ilegal është bërë kryesisht natën. Mirëpo, dhomat e konvikteve i kemi përdorë gjoja se po mblidhemi ne shoqet. Fillonim me biseda të ditës, me biseda të ndryshme. Kur u siguroshim që çdo gja osht' në rregull, atëherë futeshim në procedura për të cilat ne ishim grumbulluar aty. Krijonim plane e materialin që kishin, domethonë ilegal ku ta çonin, ku ta vendosim, nëpër çfarë pozita të qytetit, nëpër cilat lagje të qytetit. Dhe nga format, thashë, nga format ma të ndryshme. Varironte plani prej planit tjetër nga situata, nga rrethi sesi ishin rrethanat në kohën e caktuar që donim ta bënim.

Anita Susuri: A ka pasë, për shembull, sigurisht ka pasë instruksione që kanë ardhë prej tjerve që ju ndoshta nuk i keni ditë kush i ka dhanë ato?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, po, po, po, ashtu ka qenë. Ne nuk e kemi ditë as nga kanë ardhë as kush fshihet pas atyre. Ne e kemi bërë vetëm atë punën tonë që na ka takue, mirëpo mrapa nuk kemi kqyrë kah qysh tek. Ne kemi pasë atë këndvështrimin tonë përpara dhe çka duhet të bënim. Në këtë mënyrë është ruajtë ai konspiracioni, përndryshe ka pasë rrezik edhe të zbuloheshim edhe jemi zbulu dikur ma vonë edhe... po, nuk e kemi ditë domethonë... unë thashë, mu më kanë arrestu në shkollë. Unë nuk e di as kush ka mujtë me qenë, as kah ka mujtë me ardhë, fare nuk e di. Edhe mirë që s'e di edhe... mirëpo edhe nuk e fajësoj askënd.

Kjo ka qenë ni punë që e kemi marrë na me vetëdije të plotë, e kemi ditë që ndoshta ni ditë do të rrezikohemi dhe do të burgosemi sepse rrethanat kanë qenë të atilla. Isha në ni televizion para ni kohe dhe më tha, moderatorja tha, “Si s’jeni frigu?” “Po nuk jemi frigu sepse puna jonë na ka majtë, ideali për të cilën ne e kemi fillu atë punë”, dhe ideali për të cilën përcaktohesh ta jep edhe atë frymëzimin e punës që e bën, nuk kemi pytë për sakrifica, për atë që do të na gjen. Ne kemi mendu si t’ia, si të arrijmë lirinë e plotë për vendin tonë, kjo ka qenë qëllimi i përbashkët dhe kështu kemi vepru deri, derisa kemi mujtë.

Anita Susuri: Sa e di ju keni pasë edhe do kode të marrëveshjeve ose kohën kur jeni caktu ose kur keni vepru...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, po, po. Tash e shumë herë ndashe jam taku me njerëz edhe që s’i kam njoftë fare. E kemi pasë, e kemi pasë të planifikuar në një kohë të dilnim në Shqipëri për të marrë disa literaturë ilegale. Shoqja ime, Lumnije Azemi nga Ferizaji e bonën ni marrëveshje që të dilnim në Shqipëri. Unë, ishte ni djalë ktu nga Suhareka, Nexhat Kuqi, ishte punëtor i “Ballkanit” dhe ia fitova besimin tek ai që ai do të na gjen ni lidhje për të na qitë në Shqipëri.

Ai ma dha mu kodin kur... unë nuk e dija me çfarë njeri do të takohesha që ishte me banim rreth kufirit të Shqipërisë. Tha, “Ti do të shkon dhe në filan vendi, ka me të taku ni person edhe ti do t’i thuash ‘Ditë me diell’”, a din, “ai ka me t’u përgjigjë ‘Ndoshta do të bie shi masdite’ nëse është rreziku”, domethonë, potencial për të kaluar kufirin. Dhe ishte, domethonë, ditë e pavolitshme për ta kaluar kufirin edhe unë e përfundova me aq dhe u ktheva dhe erdha në Suharekë, domethonë pa rreziku me dalë.

Anita Susuri: Cili ka qenë rreziku? Pse s’ka qenë përshtatshëm?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Sepse ishte patrulla, patrulla kufitare, ku e di une. Ai masandej... unë atë njeri as nuk e njoh tash kush osht’, nuk e njoh kush osht’. Por, e kemi pasë, “Ditë me diell”, ai, “Ndoshta do të jetë shi pasdite”, a din, edhe e kom vazhdu rrugën time, jom kthy prapë edhe kështu ka, jemi marrur me shifra, me formula nga më të ndryshmet. I kemi pasë ato kodet tona. Pastaj i kemi pasë emrat ilegal e kështu me radhë.

Anita Susuri: Emrat ilegal nëse mundeni me na folë pak për qeto. E di që kanë qenë mos me ju dekonspiru dikush...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, po.

Anita Susuri: Cili ka qenë emri juj edhe nëse mundeni me e nda?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Unë edhe poezitë... se para se me ra në burg jam marrë me edhe masandej edhe tash merrem me krijimtari. Kur i botoja poezitë në “Kosovare”, shpeshherë nuk i botonin me

emrin tim. Disa poezi i kom botu me emrin tim. Ma vonë jam detyru ta boj Besa Guri, e kom pasë. E di që Esat Mekuli ka qenë në atë kohë redaktor i revistës. Pastaj, ka pasë revista edhe gazeta të asaj kohe që nuk kanë mujtë me i botu poezitë e mija. Po, unë më pëlqen edhe sot e asaj dite me pasë mundësi, veç kam pritu në mënyrë administrative me hi me e ndrru emrin (qeshë) edhe kështu me radhë. Qefseri e ka pasë emrin Arta, shoqja ime, Arta e ka pasë, e kështu me radhë. Secili e ka pasë emrin konspirativ në veti.

Anita Susuri: Thatë që keni pasë edhe shumë kode tjera për shembull. A ka qenë ni orë e caktume kur e keni zhvillu aktivitetin?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Kur e kishim domethonë donim ta krynim ni veprimtari, normal që bohej me orë të caktume. Mirëpo, ato bisedat nëpër konvikte shpesh herë bëheshin edhe vinim, bënim, vinim në mënyrë spontane. Bëheshim tri-katër shoqe edhe gjatë bisedave, gjatë zhvillimit të bisedës vinim deri te ai qëllimi që donim ta zhvillonim, ta përthekonim bisedën. Kështu që, shumë herë ato që ishin për të zhvilluar në mënyrë të planifikuar normal që bëhej me kode të caktuar. Bëhej natën nëpër lagje që ishin krejt periferike të ndryshme.

Mirëpo, kemi zhvilluar edhe aktiviteti, qysh me thanë, gjysmë-ilegale a din. Mblidheshim në ni dhomë të konviktit edhe duke thirrë njëra-tjetrën zhvillonim... pastaj edhe bashkëbisedonim, qysh u zbulu ni ngjarje, qysh u arritë ni aktivitet. Atëherë vinin grupacione nga Shqipëria të muzikës, të sportit, shkonin nëpër halla sportive, nëpër salla koncerti. Se si me entuziazmue rininë studentore, rininë e shkollës së mesme. Kanë qenë aktivitete nga më të ndryshme në prizmin e sotëm ndoshta duken të lehta, ndoshta duken të parëndësishme, por për kohën kanë qenë jashtëzakonisht të rëndësishme.

Dy shkronja, “KR”, në rrugë nëse janë shkru me vite të tana janë burgosë njerëzit për ato dy shkronja. Mirëpo, ato dy shkronja e kanë pasë fuqinë e vet, kanë bo efektin në popull. Kështu kanë ardhë, janë lidhë ngjarja me ngjarjen, aksioni me aksionin. Të gjitha këto janë lidhë në mënyrë kronologjike njëra me tjetrën edhe e kanë mbri atë fuqinë e vet.

Anita Susuri: E ju a keni shpërnda vetëm këto parullat apo keni pasë edhe shkrimin e ktyne, për shembull parullat në rrugë...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po.

Anita Susuri: Edhe shpërndarjen e materialit.

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, ku kemi mujtë me depërtu. Unë thashë, tregova rastin e shkollës të mesme, shpërndarjen nëpër qytete të ndryshme, parullat, aty ku kemi mujtë me depërtu që kemi, që kemi vretë vetën... unë thashë, për çka e falënderova nënën time kur ma bone pytjen, sepse në shumë raste na ka ndihmu edhe nana ime, në disa raste. Ajo mbuloi me atë mantilin e saj, me atë

shaminë e saj dhe ndër mantilin e saj fshihshim ne ato pamfleta që dojshim t'i shpërndanim. Kanë qenë mënyra nga më të ndryshmet. Nuk jemi marrë ni ditë e dy ditë, por me vite të tëra kemi zhvillu aktivitet, derisa jemi zbulu e jemi burgosë.

Anita Susuri: A ka qenë edhe kjo, koha kur jeni taku me bashkëshortin ndoshta?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Me bashkëshortin...

Anita Susuri: Në ilegale?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Jo. Me bashkëshortin në studime jam takuar. Mirëpo, bashkëshortin e kom pasë, mas martesës edhe gjatë fejeses edhe mas martesës e kom pasë ni krah të fuqishëm. Sepse kur jom martue, fillimisht unë jam arrestu në shkollë, jam burgosë, jam dënu me 18 muaj burg. E kam kryer burgun. Mas ni periudhe kohore jam martu dhe kam zhvillu...

Anita Susuri: Pas burgut?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Pas burgut. Pas burgut jam martu. Dhe kam zhvillu aktivitet edhe në fshatin ku kom jetuar. Atëherë lindi edhe kjo partia e LDK-së. Po atëherë në fillime ka qenë ni, nuk ka qenë si, ka funksionue si një, nuk ka funksionu si ni parti, por si një lëvizje e tërë dhe pjesa dërmuese e popullit e kemi mbështetë se u bo ni punë e mirë në kuadër të saj. Në fshatin Gllarevë edhe në komunën e Klinës kemi zhvillu aktivitete të ndryshme. Atëherë në kuadër të LDK-së ishte edhe ni veprimtari gjysmë-ilegale.

Ne e formuam Këshillin e Fshatit të Grave atje edhe në atë kohë edhe vraheshin kta të ritë nëpër burgje, nëpër armatën Jugosllave. Dhe për t'iu dhanë përkrahje familjeve që humbnin djemtë e tyre, mblihdh na gratë e fshatit, hypnim nëpër rimorkio të traktorit dhe shkonim nëpër ato fshatra. A beson që vishin gra 65 vjeçare, 70 vjeçare përveç vajzave ma të reja, grave ma të reja vinin edhe plaka të moshuara, nuk i iknin thirrjes që i bënim ne si të reja dhe shkonim zhvillonim aktivitete. Organizonim kurse të ndryshme për m'i avansue vajzat të cilat nuk ishin të shkolluara.

Masanej organizonim, bonim veprime edhe sesi me e qitë në pah rolin edhe pozitën e gruas të asaj kohe. Në atë kohë nuk kanë qenë gratë në pozita të sotshme, kanë qenë jashtëzakonisht, po them, se shumë ma ultë sesa pozita e mashkullit, qoftë në familje, qoftë në shoqëri. Këto kanë qenë ato që jemi munduar, domethonë në çdo segment të jetës të kryjmë atë, të kryjmë atë gjëjen e duhur që duhej të bëhej.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Po du pak ma mrapa me u kthy te ajo që përmendet, ardhjen e ktyne, si me thanë, shoqërive kulturore, artistike nga Shqipëria...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po.

Anita Susuri: A ju kujtohet, për shembull qysh u bo atmosfera kur ata kanë qenë të pranishëm ose...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, më kujtohet edhe sot e asaj dite e kam, më çohen mornica kur e kujtoj. A beson që ajo salla e sporteve që osht' afër...

Anita Susuri: Konvikteve?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, "1 Tetori" që është afër Konviktit të Studentëve, ajo përmbushej nuk kishte vend për të gjithë ata që ishin të interesuar të futeshin brenda. Dhe shpesh herë ne, shpesh herë ndodhte që nga jashtë ta përcillnim aktivitetin që zhvillohej brenda. Digjeshin atje sa kmisha, sa... për gjithë ai vrulli rinor. Masandej, ajo adrenalina na jipte atë mundësinë që të ndiheshim si supermen po them kështu (qeshë), edhe ndiheshim jashtëzakonisht. Edhe këto gjëra, këto gjëra e kanë frymëzu popullin. Sado që në këndvështrimin e parë janë dukë gjëra të imta, gjëra të lehta, këto e kanë bind popullin se ne i takojmë, i takojmë, domethonë kësaj fryme nuk i takojmë asaj fryme...

Se në atë kohë u bajtë edhe shtafeta e Titos, përcillej nga qyteti në qytet ajo ceremonia. E kujtoj atë ditë që bartej nga të rinjtë e Kosovës kështu me radhë. Pastaj, u bojshin dy tabora. Ai tabori që e përkrahte sistemin jugosllav dhe nuk e përkrahte. Domethonë, gjithë aktivitetet që boheshin në kuadër të RSFJ-së dhe ky tabori tjetër që frymonte me frymën e atdhedashurisë, me dashurinë për Shqipërinë dhe ishin, domethonë pothuajse të ndara e bardha nga e kuqja edhe kështu veprohej.

Anita Susuri: A keni pasë rast, për shembull, me pasë ndonjë kontakt me këta që kanë ardhë artistat e Shqipërisë...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, po.

Anita Susuri: Me bashkëbisedu.

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, e kujtoj mirë. Më vjen shumë keq që nuk kom fotografi sepse i kam të gjitha në Suedi. Me Gëzim Krujën, me këto këngëtarët, tash edhe s'më kujtohen emrat momentalisht. Po e kujtoj me Gëzim Krujën kur erdh me e lujtë ni dramë në Teatrin e Prishtinës. Ishte ai dhe ni, e rrethkuam ne studentët e ai me ato batutat e veta aq na bonte të qeshnim, të mbanim britë nga e qeshja e tij. Mirëpo edhe në atë kohë duhet të kishim shumë kujdes, sepse çdokund kije, çdokund e kishe nga një njeri ndoshta që e përcjellke situatën. Jo të gjithë ishin që e donin, për shembull Gëzim Krujën, artistët shqiptarë, këngëtarët shqiptarë. Aty involvoheshin njerëz nga më të ndryshëm.

E kujtoj kur ishte ni estradë e Avni Mula dhe këngëtarë të tjerë nga Shqipëria në Grand Hotel, populli e rrethoi Grandin edhe studentët edhe ishte ni takim me këngëtarët. Posa hypën ata në autobus për ta marrë rrugën e tyre për Shqipëri, neve filluan të na kidnapoheshin të ritë edhe popullata aty nga UDB-ashët e kohës. Ne u duheshim me gjetë mënyra nga më të... shpërndarje të rrufeshme sepse përndryshe bijshë nën kthetra të tyre dhe burgoseshe ose malltrotosh fizikisht ose mentalisht ose të gjitha ato.

Anita Susuri: E në kohën kur po thoni kur ka vazhdu edhe shkollimi i juv në fakultet, por edhe aktiviteti, sa keni mujtë me qenë pjesëmarrëse edhe në jetën në qytet për shembull? Qysh e keni përjetu edhe qytetin?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po na e kemi, normal që e kemi, e kemi jetu edhe jetën studentore përveç asaj që e bënim, përveç punës ilegale që e bënim. Vizitonim teatrin në atë kohë. Ka qenë i jashtëzakonshëm teatri, ka qenë i avancuar edhe mbante pothuajse ka pasë teatër në çdo fundjavë pothuajse. Pastaj, shkonim nëpër, atëherë nuk ka pasë sikur sot kafiteri të shumta sikur sot që ka, atëherë ma tepër janë frekuentu disa ëmbëltore me do limonada, me do boza, me do ksi farë indianka ëmbëlsira i kujtoj. Kështu që, e kemi bërë, jo në mënyrën siç bëhet sot. Atëherë kanë qenë tjera rrethana, kanë qenë ma të randa kuptohet. Studentet kanë qenë ma të kufizuara.

Atëherë, qatëherë në vitet '79, '78, '79 fillunë këto grupet e rock muzikës në Kosovë. Po kanë qenë jo të shumta, aty-ktu kanë qenë. E di që edhe ata mundoheshin ta avanconin muzikën, trendet evropiane t'i ndiqnin e të tjera e të tjera. Ne që ishim të përcaktuar nga muzika popullore, nga ajo që na, si me thanë, ju përgjigjike idealit tonë. Ma tepër domethonë jemi konë të përqendruar nga muzika folklorike, popullore, artistët shqiptarë që vinin nga Shqipëria e kështu me radhë.

Anita Susuri: Po kthena edhe pak te aktiviteti. Sa shpesh ju ka ra me pasë aktivitete?

Zyrafete Kryeziu Manaj: E keni fjalën te aktiviteti ilegal apo legal?

Anita Susuri: Te ilegalja.

Zyrafete Kryeziu Manaj: Te ilegalja sa herë që kemi pasë mundësi edhe sa herë që na është besu ni detyrë e kemi bërë atë. Ndoshta, ndonjëherë ka qenë shumë ma e shpeshtë ndoshta ndonjëherë ka qenë shumë ma e rrallë. Varej nga pozicioni i situatës sepse jo gjithëherë kemi mujtë na me e kry aktivitetin tonë në ditën kur ndoshta ne kemi dëshiruar. Po ndoshta është dashtë të bartej nga dita në ditë.

E kujtoj niherë kishim disa literaturë ilegale në konviktin numër ni. Bile ishte Zylfije Muriqi, ni vajzë, Mulliqi apo Muriqi sepse kjo të vajzërisë e ka pasë Mulliqi e kur u martu më doket e ka bë Muriqi.

Kishim në dhomën tonë disa litarutë ilegale. Ne na erdh informata që do të ketë kontrollë në konvikte, se herë pas here bohej bastisje, kontrollë nëpër konvikte, nëpër dhomat e konvikteve aty ku dyshohej se ka diçka. Unë informohem nga një shoqe e imja që do të ketë kontrollë në konvikte.

Detyrohem që ta marrim krejt materialin ilegal që kishim dhe ta çonim te ni banesë private. Banonte ni shok i imi, Tafil Rama, po njëkohësisht edhe i imi atje. Ai bile ka qenë sekretar në “Rilindje”, punonte në “Rilindje” në atë kohë dhe e dërguam te ai, e evituam. Masdite duli e saktë ajo që do të ketë kontrollë nëpër konvikte. Në disa dhoma erdhën kontrollun, fatmirësisht nuk gjetën asgjë edhe ka qenë ni kujdes i jashtëzakonshëm. Është dashtë ni kujdes, përndryshe për ni gjë ma të vogël mund të bije në burg, mund të burgoseshe, arrestohesh e kështu me radhë.

Anita Susuri: Sigurisht edhe familja e juj e ka ditë që keni qenë pjesë e ilegales, po a u bashkangjitë edhe baba juj që e përmendët ma vonë?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po. Baba im (kollitet). Më falni.

Anita Susuri: Pini ujë nëse doni.

Zyrafete Kryeziu Manaj: Baba im e ka pasë, e ka ditë sigurisht, e ka ditë që merremi me këtë punë. Shpesh herë na ka mbajtur ligjerata se si duhet të gjindemi para situatave të ndryshme, këshilla të ndryshme. Mirëpo edhe unë aktivitetin e babit tim e kam, nuk e kam ditë deri në fund, sepse baba nuk është, nuk ka folë haptazi me neve. Unë kom bashkëvepru me motrën time, tash të ndjerë ma, Myrvete Kryeziu, ajo ka qenë ma e re se une. Ajo nuk i ka ditë kontaktet e mija, me kond unë kontaktoj. Pastaj, me vendaset e mija, me njerëzit e tjerë që kam kry aktivitete, ne nuk kemi ditë për njani-tjetrin.

Ka qenë një konspiracion i madh domethonë, sepse vetëm në atë mënyrë ruhej vazhdimësia e aktivitetit. Në kohën kur kam qenë unë, në kohën kur ka qenë... faktikisht Qefsere Mala pat ra në burg para meje dhe u pat dënu vetëm me një muj burg apo dy nuk e di saktësisht tash. I patën gjetë do CD-ja të kangve, që po thom kemi bo edhe prapaganda përmes kangës. U dënu dy muaj dhe kishim ndërmend, e kemi pasë ndërmend paraprakisht të shkruanim ni parollë te Fakulteti Filozofik në pjesën anësore të Fakultetit Filozofik ku shihej rruga, edhe tash graviton rruga kryesore dy shiritëshe që osht’.

Ajo paraprakisht ra në burg. Tash unë doja të siguroja ata që do të kryhet domethonë, plani për të cilin e kemi bërë planin e veprimit. Mori pallomën, këtë pallomën higjienike e shkruaj mesazhin që do të dërgoja te ajo edhe e marrë vetëm ni fije të fletës higjienike të asaj palomës dhe bëj fitil kështu dhe e shti në jakën e kmishës. E shkepi jakën e kmishës nga mrapa e fus aty dhe i thom nanës të saj, “Kur të shkon në vizitë”, se ajo e kishte vizitën e lirë dhe nana e saj i rrëfen në vesh, “Ke diçka në jakë”.

Kur shkon ajo në dhomë atje e gjen atë letrën se çka kom dashtë me e porositë, çka kom dashtë me i thanë. Domethonë, kemi gjetë mënyra nga më të ndryshmet për ta kuptuar njëra tjetrën, për ta

kuptuar njëri-tjetrin dhe kështu, edhe kështu kemi mujtë me kry shumë punë. Përndryshe, bije në grackë. Njerëzit e UDB-ës i ke pasë kudo, kudo. Në stacion të autobusave, në kinema, në teatër, në konvikte, çdokund i ke pasën.

Anita Susuri: Unë e kom shkru ktu që ju edhe keni hartu, por edhe keni shpërnda trakte. Për shembull, çfarë trakti keni hartu ju?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Në atë kohë ishte e nevojshme që të thirret populli për ta kuptuar që ne jemi nën robni dhe për ta marrë jetën në duar. Mirëpo, për ta marrë jetën në duar punëtori në punën ku punon, diku në bujqësi, punëtori në fabrikë të gjitha kto. Po duhej, domethonë, tashi saktësisht nuk e kujtoj tekstin që është bërë, mirëpo përqendrimi ka qenë këtu që secili, qoftë punëtor, qoftë profesor, qoftë bujk, qoftë njeri me profesione nga më të ndryshme, secili ta kuptojë esencën e saj sepse ne jemi të robëruar edhe duhej të bëhej një ndryshim për ta, për ta shpërluar Kosovën.

Anita Susuri: Brenda grupit domethonë ose ilegales në përgjithësi, a ka pasë rregulla qysh me u sillë dikush nëse raste të caktume. Për shembull, nëse bjen në dorë të pushtetit ose gracka të ndryshme?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, shiqo normal që kanë qenë ato rregullativa. Duhej të kishe kujdes të mos jepshe emra, të mos i nxjerrshe shoktë apo shoqet tua. Aty osht' dashtë të trillohej situata nga më të ndryshmet nëpër pyetje kur të merrnin ato nëpër ato zyrat e hetuesisë, nga më të ndryshmet. Po aty ka qenë, në zyrat e hetuesisë ka qenë tortura psikike e barabartë me torturën fizike. Se sidomos ne femrat, ne kërcënoheshim me fjalët nga më të ndyta, fjalët më çnjerëzore që mund të përdorë njëri ata i përdornin ndaj nesh.

Frikësoheshim thjeshtë edhe nga ana morale edhe nga ana e presionit që na bëheshin. Kështu që, ka qenë jashtëzakonisht vështirë. Është dashtë të jesh shumë e vëmendëshme në pyetjet që t'i bojshin, të gjeje labirinta për të ikë nga ajo çka ata dëshironin dhe të mos ipshe emra. Sepse atëherë vegëza e nxjerrte vegëzen tjetër dhe shkante kështu me radhë. Aty ka qenë, a beso, aty vinin sa serbë, sa shqiptarë, sa hynte njëri, sa dilte tjetri. Pastaj, të linin tërë natën në kamë pa karrige.

Mu personalisht më lidhën me pranga për radiator edhe tash imagjino tërë ato tortura fizike edhe me nejt tonë natën lidhë për radiator pa pasë karrigë me u ulë. Vinte tjetri të bonte presione nga më të ndryshmet. Presionet ma të mdhaja i kemi pasë nga shqipfolësit. Se vinin serbët po ata e ruanin atë, atë farë...

Anita Susuri: Njerzillëk.

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po. Edhe merrshin në mënyra, si e kanë zakon ata atë politikën e tyre që shifeni sa të mirë jemi nuk bojmë presione si kolegët tonë. E domethonë e përdorshin atë politikën e tyre dhe i fajësojshin ma tepër njerëzit që flitnin shqip. E kështu me radhë.

Anita Susuri: Ju, kur e keni kërku përfundu, keni diplomu në vitin '80 më duket?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Jo, ma vonë, sepse jam burgosë unë e ma vonë e kam përfundu.

Anita Susuri: A ju kanë ndërpre?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, po.

Anita Susuri: E keni vazhdu në vitin?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Unë kom fillu me punu para se të diplomoj '80-tën e kom marrë vendin e parë të punës. Pastaj isha studente edhe me korrespondencë edhe studioja edhe punoja. Kështu që, më është dashtë, jom lidhë, domethonë veprimtaria ime edhe legale edhe ilegale është lidhë shumë me qytetin tim. Merrja, domethonë atë mendimin e shokëve dhe shoqeve atje dhe vija këtu e zbatoja edhe nëpër territorin e gjerë, jo vetëm të Suharekës, por edhe në fshatra të ndryshme. Kështu që, mundoheshim që t'i njoftojmë njerëzit, me i bo për vete, që tha ti sesi [i drejtohet intervistuesë]... osht' dashtë ni oratori e përsorur për ta bind, për shembull ni njeri që ishte ndoshta shumë i afërt me sistemin e kohës. Është dashtë të flitet e të flitet, jo vetëm ni ditë po me kohë të tërë, me ditë të tëra për ta bindur. Ka qenë kohë e vështirë.

Kanë qenë njerëzit në atë amullinë e cila osht' vërtetë rruga jonë e drejtë, cila? A ndoshta nëse merrem me këtë krahun çka do të ndodhë me mu, çka do të ndodhë me familjen time? Se ka pasë njerëz, na secili kemi mendu që të mos sjellim të kqija në familje ose për vetën tonë. Mirëpo, ai që është përcaktuar për ta bërë punën për atdheun i kemi lanë mrapa ato se çka do të ndodhë me neve, çka do t'i ndodhë familjes time dhe kemi vazhdu. Mirëpo, ka pasë njerëz të cilët kanë qenë të luhatshtëm, të pabindur edhe u dashtë të punohet shumë thellë për t'i bind të gjithë kta.

Anita Susuri: Ka qenë edhe ni tregim diçka kur keni heq në vendin e punës fotografinë e Titos?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po (qeshë). Jo që e kam hequr, por në fakt nuk ka pasë. Isha kujdestare e klasës 6/2 dhe bëja mësim në atë shkollën ku është muze tash. Hy brenda dhe nuk e di tash se si disa nxënësve ju ka ra në sy që nuk e kemi fotografinë e Titos varun në klasë. Dhe unë nuk e di se si ka ndodhë ajo. Mirëpo, tash unë rash në atë situatën si t'i përgjigjem nxansave. Edhe thashë, ata thojshin... se pikërisht në atë klasë e kisha edhe ni nxanëse që e kish babën kryetar komune në Suharekë.

U çu njëri nga nxënësit po thotë, "Msuse, pse veç klasa ime, klasa jonë nuk e ka fotografinë e Titos?" Edhe unë thashë, "Po a din çka", thashë, vërtetë jashtë i kishim fotografitë e rilindasve tanë, Naim Frashërit, Avdyl Frashërit ktyre. Thashë, "Po a din çka", thashë, "po na mungojka ajo po kemi na disa

fotografi tjera që e zëvendësojnë atë në koridor”, a din. Edhe nifare mënyre i bëra sikurse... ju dhashë me kuptu atyre që neve na mjaftojnë fotografitë që i kemi atje, sesa ajo që t’ishte para neve. Kështu duhej të dilje nga situata për të gjetur varianta nga më të ndryshmet edhe për t’i kaluar situatat.

Anita Susuri: Po, ‘81-tën kur kanë fillu demonstratat në mars...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po.

Anita Susuri: Paraprakisht a keni ditë që kanë me ndodhë?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Unë kam qenë duke punuar në shkollë, në shkollën ktu, “Bashkim-Vllaznim”, [emri] të asaj kohe, sot është, “7 marsi”. Qefserja, shoqja ime më lajmëron që do të ketë, do të ketë demonstratë me 26 mars, se ato me 11 mars veç u patën kry. Edhe unë shkoj në shkollë, e lash palltën time në shkollë. Niherë u hamenda që të mos tregoj se ku po shkoj, mirëpo e dija se me mungu tërë ditën drejtori do të merr masa, nxanësit pse po bojnë zhurmë, pse kështu.

I thashë ni kolegut tim që do të shkojmë bashkë në Prishtinë. Ai kishte punë diçka për makinën, për punë personale, nuk e dinte që do të zhvillohet demonstratë në Prishtinë. Më tha, tha, “A mund të më zëvendësojsh mua se do të shkoj në Prishtinë?” “Jo”, thashë, “une”, thashë, “kom provim në Prishtinë edhe unë do të vi në Prishtinë”, edhe thashë, “do të shkojmë bashkë me makinën tane”. E njoftova drejtorin që do të shkoj në Prishtinë se u duhke dikush që të mi plotësoj orët e mija. E lajmëroj gjithashtu edhe ni kolegën time dhe shkojmë në Prishtinë atje.

Bile, ai ia majti kah konviktet e studentëve sikur ta dinte, ai nuk dinte në fakt që do të ketë demonstratë aty. Unë thashë, “A din çka”, thashë, “nalëm qitu se kam me u taku me ni kolege”, thashë, “që e kemi bashkë provimin edhe shkojmë bashkë aty”, ai m’tha mu, “Sot osht’ shtafeta e Titos kokan bo”, tha, “studentat zaherë po shkojnë atje në që do të bartet shtafeta e Titos”, edhe unë s’i bëj zë hiç. Ai shkon me makinë, unë nalëm aty. I gjej grumbullin e studentëve në oborrin e konvikteve aty.

Aty u zhvillu ni debat mes Azem Vllasit, Sanije Hyseni ka qenë ajo, vinte nga Komiteti i atëhershëm. Studentat me ato ankesat fillunë të dalin me kërkesa politike, “Lironaj shoktë nga burgu”, “Trepça punon, duhej të punoj për Kosovën, jo për republikat e tjera jugosllave”, aty lindi, “Kosova Republikë”, e pastaj parulla tjera. Dhe ata nuk u bindën, domethonë as Azem Vllasi, as Sanija nuk u bindën me ato kërkesat tona edhe na lanë neve, ata shkun në punën e tyre. Ne bënim punën tonë dhe vendosëm të dilnim në qendër të qytetit.

Mirëpo, ishte ai barrakadimi te menza e studentëve dhe te ai kryqëzimi i rrugës nga policia e kohës. Ishte shumë e pamundur për të dalë në qytet, se atje zhvillohej, pritej ajo shtafeta e Titos. Ne kënde bënim protesta edhe demonstrata dhe nuk, nuk mundëm të dilnim në qendër të qytetit. Mirëpo, i gjithë aktiviteti i asaj dite u zhvillu në oborret e konvikteve, në atë platonë te salla “1 Tetori” tash dhe

zhvillohej domethonë aty. Po ka qenë, aty kam parë vajza e djem që janë arrestuar, janë malltretuar në forma nga më të ndryshmet. Po ajo adrenalina neve na mbante, na mbante gjallë dhe deri në orët e vona të natës domethonë ka vazhdu protesta.

Anita Susuri: A ka pasë dhunë, a kanë përdorë armë, për shembull të nxehta?

Zyrafete Kryeziu Manaj: E di që ni demonstrues është plagos me atë gazin lotsjellës se është mundu ta kthej dhe i ka shkurtu tre gishta më duket. E rrahje ka pasë, ka pasë, ka pasë, ata kond kanë mujtë me nuanë, sepse turma ka qenë aq e madhe sa depërtum nëpër konvikte nëpër asi... unë kom pasë fatin me qenë te ajo platoja dhe nuk, nuk jam arrestu, nuk jam, atë ditë domethonë nuk më ka gjetë gja. Pastaj jemi shpërnda nëpër shtëpija. Njoftë e pa njoftë kemi hy nëpër shtëpija kemi fjetë atë natë edhe jemi strehuar.

Anita Susuri: Ku keni shkuar ju, për shembull?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Unë kam shku me shoqën time me Qefseren te ni vendas i saj në Kodrën e Diellit e ka pasë shtëpinë edhe kemi pasë fatin që ajo ka pasë vendas të saj dhe e kemi njoftë. Ka qenë njeri i besueshëm i joni dhe jemi futë aty kemi bo natën. Të nesërmen në mëngjes kemi marrë libra kinse po shkojmë në fakultete edhe jemi shpërnda secili në punën e vet, sepse të nesërmen nuk ka pasë domethonë, demonstratë. Jemi shpërnda deri me 1 e 2 prill nuk ka pasë. Mirëpo 1 e 2 prilli kanë qenë të koncentruara në Prishtinë, pastaj 3 prilli sa kujtoj unë ka qenë në Ferizaj e kështu me radhë në qytete të ndryshme ka pasë protesta nga më të ndryshmet.

Anita Susuri: E me 1 e 2 prill [1981], a keni qenë në Prishtinë?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Jo, unë nuk kam qenë, nuk kam qenë...

Anita Susuri: E në Suharekë qysh ka qenë situata?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Edhe në Suharekë ka pasë organizime, ktu e ka pasën organizimin kryesor është bërë në Prizren. Në Prizren ka qenë motra ime e ndjerë edhe është arrestuar. Dhe është interesant për të thanë se kur është arrestu ajo, tash kanë qenë tre policë edhe dy policë të tjerë kanë shku për të marrë nxanësit e tjerë. Se kryesisht është bërë nga studentët e Prizrenit të Shkollës të Lartë dhe nga shkollat e mesme, nxanës të shkollave të mesme.

Ai polici që ka mbetë vetëm e ka kthi shpinën, i ka dhanë me kuptu kësaj që, "Ik, ti!" a din. Kjo ka ikë në atë moment dhe u futë me ni shtëpi private, ka qëndru deri kah mramja dhe gruaja e asaj shtëpie e ka marrë e ka çu te stacioni i autobusave. Sepse edhe stacioni i autobusëve është mbikqyrë nga UDB-ja dhe njerëzit e saj. E ka marrë gjoja se po shkon te daja, e ka hyp mrena në autobus. Me dëgju tjetër i ka thanë, "Hajt vajza ime, të fala i bën dajve edhe nesër prapë të pres ktu te stacioni i autobusave edhe

shkojmë në shtëpi”. Pastaj ka ardhë në shpi edhe kështu u kry ajo, ajo mramja e asaj nate. Domethonë edhe këtu ka pasën aktivitete.

Anita Susuri: E ju pas asaj dite, mars që keni qenë në demonstratë, a kanë qenë të shqetësuar kur jeni kthyer në shpi? A keni pasë kontakt?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, po. Unë kom ardhë në shpi pastaj edhe po baba, baba priti lajmin, çfarë lajmi do të sjellim nga Prishtina, nana gjithashtu. Ka qenë... atëherë... pastaj demonstratat e kanë dhanë një frymë të re situatës në Kosovë. Unë mund të them se demonstratat e marsit e prillit të asaj kohe kanë qenë bazament i shtetit të Kosovës së sotshme. Dhe në vazhdimësi pastaj ka pasë protesta, ka pasë demonstrata, ka pasë organizime të ndryshme deri në vitet e ‘90-ta. Masandej që e bonën masovike që e hjekën këtë farë autonomine e Kosovës, që dul popull i tërë nëpër rrugë. Atëherë masandej kërkonin Azem Vllasin e Kaqusha Jasharin. Ata neve dikur na dënonin e na dënonin. Mirëpo, ka qenë situata e tillë që i kërkonin për hir të situatave që u zhvillonin në periudhën e caktuar kohore. E kështu.

Anita Susuri: Po edhe politikanët ndryshonin varësisht situatës...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, natyrisht. Po edhe sot e kësaj dite, sot unë njoh njerëz që kanë qenë si thojnë ia kanë majtë zhagun Jugosllavisë e Serbisë së atëherëshme edhe sot dalin e na bëhen ma patriot se ata që janë sakrifiku në atë kohë, kanë bo me vite të tëra burgje e janë rrahur e malltretuar e janë anatemuar. Sot shpesh kur i shoh me thanë të drejtën më vjen, befasohem se si munden. Për shembull, njerëzit e tillë me e shpërfaqë profilin e vet edhe me ju përshtatë situatave të kohës.

Por ata infiltrohen dhe iu përshtatën çfarëdo situatave që të vije. Kurse ata që janë njerëz ideal, ata qëndrojnë, qëndrojnë me atë parimin kush ishin edhe do të mbesin deri në fundin e jetës së tyre, domethonë të pandryshuar. Të pandryshuar në mënyrë pozitive të asaj që e kanë bërë edhe asaj, domethon, edhe sot e kësaj dite Kosovës i duhen njerëz. Patjetër që i duhen njerëz dhe njerëz të devotshëm e krijojnë një shtet të fortë.

Njerëz që janë labil në jetë dhe që mundohen të përfitojnë për familjen e tij, për vet personin, për... ata janë të dëmshëm edhe për shtetin, për shoqinë edhe për të gjithë. Po tash shpresojmë, ndoshta edhe dalin gjenerata edhe ma të reja edhe ma të avancuara, qoftë politike, qoftë në profesione edhe të... ta ngjallim këtë Kosovë se u bën 20 e ca vite ende, ende nuk funksionojnë mirë si duhet shkollat tona, nuk funksionojnë mirë universitetet. Pastaj çka osht’ për të ardhë shumë keq spitalet tona, mjekësia jonë.

Nashta une i bëra 31 vite në Suedi dhe kam bërë jetë sa në Kosovë sa në Suedi. Kur vi nga ajo jetë dhe e shoh situatën në Kosovë me të vërtetë më duket vendi im që bën... është në një situatë jo të lakmueshme, jo ashtu siç duhet të jetë. Ne kemi menduar që mas luftës në Kosovë, Kosovën do ta

avancojmë si shteti Zvicërran edhe shpesh e kemi përdorë këtë nëpër kontaktet, bisedat tona e sene. Por, shumëçka u devijoi mas luftës. U devijoi nga vet politika së pari e pastaj nga njerëzit e komunave, nga njerëzit institucional. E kështu që duhet të ndryshohet, duhet të bëhet diçka ma mirë.

Unë nuk jam njeri politike, nuk merrem fare me politikë, s'jam anëtare e asni partie politike, mirëpo di me dallu të mirën nga e keqja, të ligën nga ajo e vështira. Shpresoj se do të bëhet diçka ma mirë.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Ju jeni burgosë pastaj në '82-tën, në fillim në muajin shkurt...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po.

Anita Susuri: Thatë që kanë ardhë në shkollë, po qysh e kujtoni krejt qat' rast?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Unë në fakt isha në proces mësimor, në orë të mësimit dhe ky njeri i UDB-së, ky kishte shkuar te drejtori i shkollës dhe më kishte kërkuar mua. Dhe drejtori e dërgon mirëmbajtësin e shkollës, thotë, "Shko thirre mësuesën Zyrafete". Po nuk... ai me siguri... a ka pa që kush është aty brenda ose ka pa, unë nuk i di detalet e atij. Po e kom pa që kur ka ardhë ai të më ftojë mua, ka qenë, nuk ka qenë, ka qenë i stresuar në nifare mënyre dhe bile as atë përshëndetjen e zakonshme që e bënte, "Mirëdita, mirëmëngjes", nuk e bëri veç e hapë derën tha, "Mësuese", tha, "të kërkon", tha, "drejtori të shkojsh urgjentisht në sallën e... në zyrën e tij".

Unë befasohe mënyrën se si, në atë mënyrë, a din m'u drejtua. I thom nxënësit kujdestar, "Interesoju ti për kujdesin në klasë derisa të kthehem unë". Dhe shkoj në zyrën e drejtorit e shof atë personin aty. Unë ata e kom pa nëpër rrugë të Suharekës edhe e njihja si ftyrë. Mirëpo, nuk e kom ditë që ka qenë i involvuar në Sekretariatit e Punëve të Brendshme të asaj kohe. E shof aty. Para se të më fliste drejtori, më foli ai, më tha, "Më njef kush jam unë?" "Po", thashë, "të kam pa nëpër rrugë të Suharekës po..."

Anita Susuri: Ka qenë shqiptar?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Shqiptar ka qenë. Thashë, "Të kam pa", thashë, "nëpër rrugë të Suharekës", thashë, "si ftyrë e di kush je". Tha, "Unë jam inspektor", tha, "i Sekretariatit të Punëve të Brendshme të Kosovës", edhe e kuptova meniherë arsyen edhe qëllimin pse ka ardhë aty. Nga aty më mori me pruri në stacionin e policisë në Suharekë dhe më mori në bisedë informative në pika të trasha ashtu dhe pastaj më dërgoi në SUP-in e Prizrenit. Dhe aty tana e dorëzoi, domethonë punën e tij tek Daut Morina ka qenë ai i cili, domethonë "supovci"³ që e ka pasë lëndën time. E ka qenë ai kryesori domethonë. Po

³ Serb.: *Sekretariat Unutrašnjih Poslova (SUP)* - Sekretariati i Punëve të Brendshme. Nisur nga akronimi në gjuhën serbe: SUP, supovci janë quajtur të gjithë ata që kanë punuar në Sekretariatit e Punëve të Brendshme.

pastaj vinte ky që thashë ma herët, Krasniqi e vinin disa serbë. Tash ia kom harru emrat, fatkeqësisht edhe emrat e tyre i kom harru sepse kam dashtë me i fshi nga memoria ime.

Hinte njëri, dilte tjetri. Pytje nga më të ndryshmet. Sa kanë qenë të vështira torturat fizike, aq të vështira kanë qenë edhe ato psikike sepse kërcënoheshin me fjalor nga më të ndytit. Unë s'muj të shprehem ktu, fjalorin ata që e kanë përdorë. Mirëpo, për vajzat, për gratë që kanë qenë të burgosura kanë qenë, përveç torturave fizike ka qenë ma e dhimbshme ajo se kërcënonin, të preknin në moral, të detyronin të bëjë skena të palakmueshme. Mirëpo, ne kemi qenë dinjitoze në veprime tona. Kemi qenë dinjitoze. Për mu ka qenë ma e rëndësishme të më vranin aty apo shumë herë jemi alivanosur nga torturat. Ata mundoheshin në ato mënyrat e veta shtazarake.

Unë them shpesh herë se as gestapo hitleriane nuk ka bërë gjëra të tilla edhe nuk janë sjellë në mënyrat në të cilat janë sjellë njerëzit që flitnin shqip. Edhe ktu ka qenë ajo e keqja, se bënë ata që flitnin shqip. Nuk bënë ata që e pritnim që të gjitha të kqijat vinin nga ata, mirëpo na bënë kta që flitnin shqip, na flitnin në gjuhën tonë. Kjo ka qenë e dhimbshme.

Anita Susuri: A ka pasë dhunë fizike? Rrahje?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Ka pasë.

Anita Susuri: Prej disa personave apo...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Ka pasë. Shumë herë janë bo dy e tre, nuk ka qenë vetëm një individ. Shumë herë është bërë dy e tre, e... Unë kur ka qenë ni rast po tregoj ktu në Suharekë, Teuta [Bekteshi] nga Kumanova ni vajzë studente e mjekësisë edhe ni vendase e imja ktu Shemsije Elshanaj dhe ato ishin vendosur që, kishin shkruar ni parollë, "Kosova Republikë", në ni pëlhurë të gjatë dikund gjashtë-shtatë metra dhe e kishin planifikuar ta lshonin në ndërtesën ma të lartë që ka qenë në Suharekë në atë kohë, në qendër të Suharekës ka qenë. Ato nuk kanë arritë me zbërthy, me lshu te poshtë ata dhe janë zbuluar më vonë.

Njëra prej atyre, Shemsija vjen në familjen tonë, kurse Teuta shkon te ni familje tjetër. Ato i arrestojnë mas ni dite më duket. I arrestojnë edhe vijnë na arrestojnë edhe neve, mu edhe dy motrat e mija edhe atë vajzën tjetër që ishte Teuta te ajo, Selvije, mbiemri s'më kujtohet. Mu edhe motrën time mas meje na vendosën nifarë si dhome ke e errët aty, më doket që shërbejke ai kafe, shërbejke për ku e di une, ai që, mirëmbajtësi aty. Na mbyllën me çelës atë dhomën ne mbetëm mrena. Kurse e merrnin në pyetje motrën time të vogël, në katin mbi ne dhe e torturonin fizikisht dhe unë e dëgjoja zhurmën e saj...

Anita Susuri: Sa vjeçe ka qenë?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Ka qenë 16-17 vjeçare ajo. Edhe me të thanë të drejtën i mshoj asaj derës edhe thyhet ajo reza edhe filloj të ngjitem shkallëve lartë të shkoja ty edhe të shoh çka po bohet aty. Edhe dalin dy policë tjerë prej zyreve më kapin domethonë s'më lejojnë me shku atje lartë. Kto kanë qenë, ata e bonin qëllimisht, domethonë i bënëin torturë asaj për ta dëgju ne torturën, për ta dëgjuar edhe me na shpartalluar psikikisht për të dhënë detaje, për të dhënë informacione. Mirëpo, ne kemi qenë të vendosura në atë aspekt dhe i kemi rezistuar të gjitha atyre gjërave...

Anita Susuri: Kjo ka ndodhë ma herët apo në kohën kur jeni arrestu?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Kjo ka qenë mas burgosjes time.

Anita Susuri: Aha.

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, mas burgosjes time domethonë. Edhe motra mas meje Myrveti ka qenë edhe ajo e dënume dy muaj. Këtë, kjo ka qenë, jam çu në burgun e Mitrovicës. Kta edhe shoqën e saj e kanë arrestue në Suharekë. Po motra paraprakisht ka qenë smutë dhe mjeku ktu në Suharekë i thotë të shkoj edhe të operohet në Prizren. Shkon ajo shtrihet në spital dhe operohet në atë ditë dhe atë ditë që operohet shkon UDB-ja për ta arrestuar në spital. Mirëpo, aty qëllon Arif Elshani, ni kryetëknik medicinal edhe në bashkëpunim me mjekët edhe nuk lejon. Se ajo e sapo operuar dhe nuk e lejojnë, domethonë ju kanë thonë kjo është pacientja jonë ku e di çka i kanë thonë dhe nuk e kanë lshu atë ditë me shku.

Mirëpo, të nesërmen kanë shku ata e kanë marrë edhe e kanë marrë e kanë çu në dhomat e sigurisë në Prizren edhe e kanë malltretue fizikisht e psikikisht edhe e dënojnë dy muj edhe e bijnë në burgun e Mitrovicës. Aty unë njoftohem... se në burgun e Mitrovicës ka qenë interesant, ne u informoheshim posa vinte ndonjë e re e burgosur aty. Unë isha në ni dhomë, ishte në fund të koridorit ajo dhoma dhe motra ime ishte në dhomën numër tre. Po thojnë, "Erdh ni vajzë e re, ni nrxanëse e shkollës të mesme nga Suhareka".

Unë meniherë pys, "Kush është ajo?" Se ne e dinim kur hynin e kur dilnin gardienët nëpërmes takave aty kur depërtonin në koridor e dinim dhe dhoma e parë që ka qenë në burgun e Mitrovicës që ka qenë domethonë afër derës kryesore ku hyhej në pavijonin e grave dhe vajzave, merrje informacionin që hyri gardienja ose dul gardienja edhe ajo me anë të trokitjeve, të goditjeve e dinim domethonë, ato shenjta e tona, u merrshim vesh. Kur dulën gardienët ne hypëm dhe e morëm vesh kush ka ardhë. Unë e kuptova, domethonë fola me motrën time që ishte ajo.

Ajo e tregoj historinë e vet qysh ka ardhë, qysh e kanë marrë nga spitali i Prizrenit, qysh e kanë çu në hutuesi, qysh e kanë dënu dy muj ditë edhe e kanë pru aty. Normal, unë jom ni keq sepse e kam ditë që motra ime mas operimit nuk ka qenë mirë fizikisht aty, por ata i kanë shfrytëzu të gjitha këto gjëra, i

kanë shfrytëzuar për të na ulur për tokë edhe për të dhënë informacione edhe për të ra në ndikimin e tyre. Ne jemi mundu në atë tonën që të mos binim në ndikim e tyre, të qëndronim, kështu me radhë.

Anita Susuri: Kur keni dalë para gjykatës, gjykatorës po mendoj, cila ka qenë aktgjykimi ju? Me çka...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, unë jam dënu nga Neni 133 Propagandë për armiqësi ndaj sistemit të Jugosllavisë, ndaj Jugosllavisë. Ai nen domethonë prej ni vit deri në dhetë vite nëse nuk gaboj ka mujtë të dënohet njeriu. Unë jam dënu me 18 muaj siç thashë. Pas burgut më janë kufizu të gjitha të drejtat e mija. S'kam pasë të drejtë as të punoj, as në institucione shtetërore, as të merrem me aktivitetin sportiv siç jam marrë, me aktivitetin letrar. Domethonë, ose kom ndryshu emrin ose gjeja lidhje miqësore për të botuar kështu ndonjë poezi aty ktu.

Kështu që, domethonë kom qenë nga ai burgu i vogël kom dalë në këtë burgun e madh që është thirrë Kosovë edhe derisa jam martuar me bashkëshortin. Para se të martohem unë kom bërë kurorëzim me burrim tim për të ndryshuar mbiemrin. E kam ndryshua mbiemrin edhe kom pasë mundësi të punoj pastaj nja katër-pesë vite në komunën e Klinës. Mas pesë vite më bijnë në gjurmë edhe aty dhe m'largojnë edhe aty. Prej atyhit shkoj në komunën e Lipjanit, në Gadime. E shoh në gazetë që kërkohej ni punëtores e edukatës fizike atje, kërkohej ni arsimtar. E çoj kërkesën time atje, më pranojnë edhe punoj aty disa muj. Po kërkonin këtë karakteristikën e përshtatshmërisë politike që kërkohej në atë kohë. Unë s'kisha ku ta merrja.

Në rastin e parë bashkëshorti e ka marrë në mënyrë ilegale në Komunën e Klinës. Domethonë pa protokol zyrtar e ka marrë atë dhe e ka çu te ku duhej te sekretarja e shkollës. Në këtë mënyrë atje, pastaj mas pesë viteve kta "komitetlinjtë" me siguri kanë bashkëpunuar, kanë bashkëvepruar dhe më kanë ra në gjurmë dhe më kanë dërgu. Kurse kur u punësova në komunën e Lipjanit, në Gadime, aty s'kisha ku ta merrja ata. Dhe pas tre mujve, më doket tre muj kom punu, më largojnë edhe nga aty edhe s'kisha ma tjetër rrugëdalje tjetër përveç se të emigroj. Ndjehesha e rrezikuar edhe në atë kohë, për shkak të aktivitetit tim që bëja në komunën e Klinës me Forumin e Gruas. Isha e detyruar që me familje të emigronim jashtë atdheut.

Anita Susuri: Po du edhe pak me u kthy te burgu, kur jeni gjyku a keni qenë grup apo...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Jo, unë jom dënuar vetëm. Unë jom dënuar vetëm nga ky nen. Jam shumë e lumtur që prapa vetës nuk kam pasë njerëz tjerë, vetëm jam dënuar. Pastaj, aty në burg, në të vërtetë në gjykatë ka qenë baba im, nëna ime dhe nuk ka pasë, ka qenë e ndaluar për njerëz, domethonë për opinionin e gjërë. E kujtoj, ka qenë ni zyre atje, gjykatësi, ni mbrojtësi im. Unë nuk kam kërku as mbrojtës, vet këta, sepse sipas rregullativës shtetërore është dashtë të jetë ni mbrojtës aty. Jam dënuar. Kam majtë ni pjesë të burgut në Mitrovicë, pastaj kam shku në Lipjan.

Anita Susuri: Mitrovica si ka qenë...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Mitrovica ka qenë...

Anita Susuri: Se thojnë ka qenë ni burg shumë i keq...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Mitrovica ka qenë burg ferri, burg ferri ka qenë. Mitrovica, në burgun e Mitrovicës ka qenë burg hetues dhe derisa njëri i përfundonte hetimet, aty e ka parë të zitë e ullirit. Ne jemi munduar njëra-tjetrën ta mbronim në nifarë mënyre kur shkonim nëpër ato dhomat e hetuesisë, ta veshnim në mënyrë pak ma trashë që ta ruanim nga pendreku, nga ajo shufra metalike që e përdornin hetuesit. Mirëpo, ishte e pamundur se ata e dinin. Na zhveshnin na linin vetëm me ndonjë blluzë të hollë. Na malltretonin.

Sa herë na ka ra të fiktë e sa herë jemi lajtë me ujtë e me tesha. Na hudhnin ujë, se ata të manin me orë të tëra aty. Do të merrnin në kohën kur ishte ma e papërshtatshme për njeriun. Domethonë, të merrnin në orët e hershme të mëngjesit, atëherë kur ishte bash në atë gjumin ma të thellë. Kështu që, Mitrovica ka qenë vërtetë... ushqimi ka qenë katastrofal, nxemje nuk ka pasë të mjaftueshme, kemi fjetë nëpër do dyshekë, çka po di, të mbushur me cukla, me çka kanë qenë nuk p'e di as vet. Po ka qenë papastërtia në nivel [të lartë].

Ne sado që u mendojshim ta mbanim atë pastërtinë mrena dhomës... kemi pasë të drejtë niherë të dilnim në tualet në mëngjes, sa për të bërë ato ritualin mëngjesor, dhëmbët t'i pastronim, fytyrën dhe pjesën tjetër të ditës nuk ke pasë të drejtë të dalësh në tualet. Kanë qenë do kanta, kanë qenë me kapak dhe u dashtë ato proceset fiziologjike mrena ditës të kryhen aty mrena në dhomë. Jemi mundu e ndoshta kemi pasë probleme të stomakut e sene, e dhimtë e kto që ta ruanim atmosferën mos të krynim ato procedurat fiziologjike dhe të shkonim vetëm në, të nesërmen në tualet. Ka qenë ni burg shumë, jashtëzakonisht i randë.

Anita Susuri: A keni qenë shumë persona me ni qeli?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, aty varironte. Kur ishin kto përvjetoret e demonstratave mbingarkohej burgu. Aq shumë bëheshim në dhomë, saqë nganjëherë na dukej që edhe oksigjenin nuk e... duhej ta ndanim në pjesë. Por, nganjëherë ndodhte që mbeteshim, bon vaki vetëm. Unë e kujtoj mas arresimit tim, mas nja tre muajve ma ndrruan dhomën. Isha me Drita Kuqin, Xhevahire Rrahmanin dhe një vajzë nga komuna e Kamenicës, nuk më kujtohet fatkeqësisht emri që ishim të burgosura për aktivitet politik. Kurse kishte edhe për vrasje, për këto gjërat tjera.

Na ndrruan dhomat, mua më dërguan në dhomën numër dy nga dhoma numër katër ku isha dhe aty takova Hidajete Osmanin dhe disa vajza të tjera. Pastaj, disa që ishin të dënuara me kundërvajtje u liruan, mbeta me, vetëm unë me Hidajete Osmani dhe një grua që ishte për prostitucion aty. Hidës pastaj i erdh radha të, ajo u dënue, ju bë dënimi i plotfuqishëm dhe i erdh koha me shku në burgun e

Lipjanit. Kur shkoi ajo në burgun e Lipjanit, unë mbeta vetëm me atë gruan tjetër, Fatime, a s'di qysh e ka pasë emrin. Atëherë e pashë vetën tamon, tamon që jom në burg. Se sa ishim ne dy-tre veta që ishim me të njejtin, për të njejtën...

Anita Susuri: Kauzë.

Zyrafete Kryeziu Manaj: Kauzë, për neve ishte lehtësim i madh aty. Mirëpo, kur mbeta vetëm ose kur mbetesh me dikë që s'ta donte zemra të ishe me atë, vërtetë e nije, e ndishe vetën që je tamon në burg.

Anita Susuri: A ka pasë edhe komunikime mrena, për shembull ktu me naj letër diçka që keni shkru diçka brenda burgut?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Mbrenda burgut ma tepër kemi komunikuar në mënyrë gojore, unë personalisht për shembull, unë dhe shoqet e tjera që jemi konë. Ka qenë dhoma, pastaj kanë qenë dyert e hekurta, po mbi dyer kanë qenë... se kanë qenë në koridorin e Mitrovicës, ka qenë burgu i rrumbullakët. Ishte koridori kështu i rrumbullakët pastaj ishin dhomat. E dritaret nuk kanë kqyrë në oborrin e burgut po kanë kqyrë në koridor. E ato dritaret nuk kanë qenë me qelq, po kanë qenë vetëm kështu grilat. Ne hypshim nëpër ato shulet e derës e deri te grilat atje naltë edhe u dëgjoshim shumë mirë dhoma me dhomën, se s'ka pasë xham me pengue zërin tonë. Bisedonim, bisedonim.

Ne e nijshim njëra tjetrën me zë shumë mirë. Tashti për me identifikue cila ishte, kur dilnim në shëtitore i thojshim m'u vendosë, për shembull Lumnije Azemi, ne i kishim me emra atje, "Cuca me qenë e para, Flaka me qenë e dyta, Shkëndija e treta". Për me ditë cila është. Në atë mënyrë e dishim kush është ajo, kush është ajo tjetra e me radhë kështu e bonim.

Anita Susuri: Sa ka pasë, sa kohë ka zgjatë dhuna fizike ndaj juve?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Derisa përfundonin hetimet, derisa aktakuza bëhej e plotfuqishme hetimet kanë vazhdue. Varironte, te dikush ka qenë ma gjatë, te dikush ma shkurtë. Për shembull, unë kam qëndru në burgun e Mitrovicës tetë muj, pak pa i bo tetë muj kam qëndru në Mitrovicë. Më është bo dënimi i plotfuqishëm edhe çka është interesant, mu më kanë liru. Mas gjykatës jam liru dhe derisa m'u ka bo dënimi i plotfuqishëm. Se ata ta jipnin ni hapësirë kohore për me bo ti ankesë edhe pastaj ose t'u ngritke dënimi ose t'u zvogëlojke.

Unë prej burgut të Mitrovicës, prej burgut të Mitrovicës kur kom shku në gjykatën në Prizren jam liru. Pas ni viti kam shku edhe kam vazhdu burgun në Lipjan, në burgun e Lipjanit. Ka qenë, domethonë burgosja ime... kjo për çka është përdorë nuk e di as vet. Ka qenë ni variantë që mu të më linin të lirë për të gjetë hallkat e mija ose njerëzit që vinin më vizitonin në familje. Për shembull, shoqet e mija shpesh herë kanë ardhë në mënyrë ilegale kanë ardhë të më vizitonin kur kam dalë prej burgut, sepse

ne nga burgu e patëm, e patëm bërë çdo burgosje që të lirohej shkonim fillimisht në familje të shoqeve tona.

Unë, për shembull, kur jom liru nga burgu i Mitrovicës... se u bë gjykimi në Prizren. Unë u dënova me 18 muj burg dhe tashi duhej të shkojsha t'i merrsha rrobat e mija që i kisha në Mitrovicë. Shkoja me atë kerrin e policisë me të cilin më bartën nga Mitrovica për Prizren. Duhej të kthehesha me të njejtin kerr të shkoja në Mitrovicë t'i merrja rrobat e mija dhe të vinin familjartë e mi pastaj të më merrnin me veturë civile domethonë. Unë thashë, "Nuk" i thashë vllaut tim, "nuk du të vi direkt në shpi, du të kthehem në Shtime", sepse ni shoqe e imja ishte e Shtimës që ishim në burg në Mitrovicë edhe duhet t'i informoj familjartë e saj për situatën e saj, për gjendjen e saj në Mitrovicë. U kthym aty, nejtëm.

Pastaj kam vizitu familjartë e Teuta Bekteshit në Kumanovë, në Maqedoni. I kemi bërë vizitat nëpër të gjitha ato shoqe që na krijohej mundësia të shkonim dhe të flitnim për burgun aty. T'i siguronim familjartë, t'ia hekim atë... sepse ata me atë drojen se si po kalojmë ne aty, çfarë rrethana janë, çfarë gjendje. Pak me i stimulu familjartë që ne nuk kemi qenë edhe aq keq sa pretendohej. Së paku moralisht nuk kemi qenë keq, e kështu me radhë.

Anita Susuri: E burgu i Lipjanit qysh ka qenë?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Burgu i Lipjanit ka qenë pak ma ndryshe, ka qenë burg i hapun, burg i lirë thirrej në atë kohë, sepse kemi pasë vizita të lira. Domethonë, nga pavioni ku ishim ne, shkonim, ishte ajo salla e takimeve edhe çka ka qenë ma që na bënte të ndiheshim mirë, kur shkonim në atë zyrën e sallëve të takimeve na nuk i takonim familjartë tonë s'pari, po shkonim te familjartë e shoqeve tona. U përshëndetnim me ata, shkonim, rrinim. Besa iu kushtojshim disa minuta familjeve tjera edhe pastaj vinim te familja jonë. Ka qenë ni organizim i jashtëzakonshëm, ni ndjenjë ngazëllyese, ni ndjenjë shumë, shumë pozitive. U mbusheshim përbrenda me atë farë, me atë farë ndjenjën, atë parimin. Sepse ne jemi për të gjithë dhe gjithë ata janë për ne. Kështu edhe kështu i kalonim në fakt ditët në burg.

Anita Susuri: Qysh ka qenë situata me familjen, a kanë pasë të drejtë, sigurisht kanë pasë të drejtë me ardhë me ju vizitu po edhe a janë shqetësu ata?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, sigurisht që janë shqetësu, sepse na në fakt nuk kemi mujtë edhe të bisedonim krejt çka ne dëshironim të bisedonim. Se edhe pse ka qenë burg i lirë në Lipjan, kanë qenë gardienët aty. Mirëpo, çka ka qenë ma e rëndësishmja sepse në burgun e Lipjanit nga shumë gardiene, shumë nga gardienët i patëm bërë edhe për vete. Edhe sillëshim me to sikur me qenë shoqe tona, a po kupton? Për shembull, e kujtoj ni rast kur Kadrie Gashi ka qenë e lënduar nga syri në hetuesi edhe ia bojnë ni operacion në Prishtinë. Kur e bijnë në Lipjan asaj i keqësohet gjendja dhe ne kërkonim që t'i binin mjek aty ose ta merrnin atë dhe ta dërgojnë te mjeku.

Asaj nuk ia zgjidhnin problemin, domethonë e linin në qat' gjendje dhe ne u revoltuam dhe u çuam në protestë. Na murrën na çunë nëpër ato birucat e vogla, në vetmi thirreshin në atë kohë, na dërguan aty. Tash vinte ai gardieni... se vetmitë ishin në pavionin e meshkujve edhe kujdestaronin polic të meshkuj. Vinte ai gardieni na hapte ato, shpikunka u thojshim atyre vrimave të vogla, i hapte ato edhe na thonte neve, "Tashti ju mund të komunikoni mes vete. Mirëpo, kur ta dëgjoni kollitjen time ju duhet absolutisht ta ndalni bisedën". Domethonë, kanë qenë edhe ata që, kur ishin gardienët e mirë kontribonin pozitivisht në anën tonë.

Kurse gardienët aty në pavionin e grave e vajzave, me ato filluam të hynim edhe ma thellë e t'i bënim për vete e besa na binin gjëra edhe që ishin të ndaluara aty në burg. Kështu që, disa nga ato edhe sot e kësaj dite ruajmë kontakte me to (buzëqeshë), tash nëpërmjet mjeteve, rrjeteve sociale e këto. A në Lipjan ka qenë tjetër histori. Në Lipjan [Mitrovicë] ka qenë, ka qenë... gardienët kanë qenë tepër rigoroz e gardienët kanë qenë tepër rigoroz. Ka qenë... po na merrshin edhe kur na zishin që thashë atë historinë e bisedave, na çojshin na çojshin në zyrë atje edhe na kërcënojshin. Por, ne vazhdonim atë tonën prapë (qeshë).

Pjesa e Pestë

Anita Susuri: Më tregutë problemet që i keni pasë pas burgut, domethonë e keni hupë edhe të drejtën e përfundimit të diplomimit...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po. E kam pasë edhe ni provim për të diplomu, dy në fakt. Unë kam qenë shumë e rrezikuar që të mos, të mbes edhe pa diplomuar. Duke ju falënderuar Gafurr Kabashit, ktu ni vendasit tim, i cili ka pasë kontakt shoqëror me profesorin tim të gjimnastikës, se provimin e veglave e kam pasë të papërfunduar. Neshat Koshi ka qenë profesor i im i Gjakovës dhe me të thanë të drejtën ai edhe nuk më ka munduar shumë në atë provim edhe e kom përfundur domethonë. Kom diplomu duke ju falënderuar sepse ky ia pat' rrëfyer situatën time atij. I ka tregu që kam qenë në burg e krejt ato edhe ai e ka vlerësue mundin tim edhe me nifarë mënyre ma ka dhanë atë provimin në mënyrë jo aq sa duhet të jem efikase për provimin, por e kam kalu edhe kështu kam arritë të diplomohem.

Por, kjo puna e punësimit ka qenë, ka qenë shumë e vështirë në atë kohë për të, për të vazhduar punën edhe për të punuar në mënyrën çfarë ti ke dashtë ta zhvillojsh para nxënësve tu. Se unë shpesh herë orën e lëndës fizike e kam shndërru në historike ose diçka të tillë, a din. Se në atë kohë edukata fizike si lëndë ka pasë vështirësitë e veta, s'i ka pasë rekuizitat e mjaftueshme për ta zhvillu orën e mësimit taman siç e kemi në mënyrë pedagogjike, siç e kemi mësuar ne se si duhet të mbahet. Na kanë mungu veglat e ndryshme. Unë në Suharekë e kom pasë sallën e edukatës fizike, në Gllarevë nuk kom pasë asgjë. E kom pasë përveç topave, ni asi gjyle që mësohej taktika e hudhjes së gjylës edhe absolutisht asgjë tjetër s'ka pasë. U dashtë të improvizoj gjërat për ta zhvillu orën e mësimit. E aty shpesh herë e kam, kam zhvillu histori e gjeografi e gjëra, të tjera.

Anita Susuri: Më tregutë edhe për bisedën informative që ju kanë marrë motrën që e kanë marrë që e kanë malltretu. Po a ka ndodhë edhe tjera që kanë marrë?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, po. Kom pa shumë herë, jo veç unë po shumë herë e kanë marrë babën, e kanë marrë motrat, vëllezërit e mi. Vllaut tim iu ka refuzu e drejta e punësimit. Ka qëndru, dymdhjetë vjet ka qenë profesor i diplomuar edhe nuk ka arritë të, ta marrë vendin e punës, derisa ka ra ky sistemi arsimor që ka qenë nën ombrellën e sistemit jugosllav. Derisa ka Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë që lajshin në atë kohë që u pat' formula edhe patën marrë institucionet e Kosovës, domethonë arsimin e do... pastaj ka punuar në këto shtëpitë-shkolla. Bile ky vëllai im nuk jeton ma, sepse e ka marrë kovidi me veti.

Unë e kam bo ni monografi për jetën e tij. Ka qenë aktivist shumë i madh këtu në komunën e Suharekës, jo vetëm. Edhe themelues i Lidhjes Demokratike. Ka qenë njeri shumë partiak ky, nuk ka dashtë me ndjekë atë sistemin monist, se ka qenë themelues i degës së LDK-së në Suharekë, ka qenë themelues i AAK-së edhe i ni partie tjetër. Ata s'e kom ditë, bile ma thanë në kontakt me shoktë e ktij që nejta para dy-tri dite. Mirëpo, familja jonë çdo herë ka qenë në sy të sistemit edhe na kanë kufizu shumë gjëra. Siç e potencova edhe ma herët, motrat kanë qenë të larguara nga shkolla. Motrës të vogël nuk iu ka lejua studimi, as motrës tjetër. E kanë, domethonë nuk e kanë lejua që të studionin. E kështu me radhë.

Anita Susuri: E këto biseda a kanë pasë edhe dhunë fizike?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Në biseda informative?

Anita Susuri: Në biseda informative.

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, po. Kur çdo herë kur, domethonë njerëzit e UDB-së nuk kanë qenë të kënaqur me të dhënat tona, me, s'kanë mujtë me marrë atë që kanë dëshiru normal që ata janë munduar që nëpërmes dhunës fizike të arrijnë aty cakun e qëllimit. Por, aty, domethonë ata kanë pretendu po nuk kanë mujtë asniherë me arritë qëllimin e tyre.

Anita Susuri: Në vitin 1990 ka fillu edhe fushata e pajtimit të gjaqeve...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po.

Anita Susuri: Edhe e di që edhe ju keni marrë pjesë. Nëse mundeni këtë me na...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Unë, me thanë të drejtën, nuk kam mujtë të jem shumë shumë aktive në këtë drejtim sepse e kam pasë vajzën time një vjeçare. Mirëpo, isha në Suharekë te baba edhe vjen ni shok i

imi më thotë, “E kemi ni pajtim të gjaqeve në ni fshat ktu të komunës së Suharekës edhe duhesh të jesh patjetër”. Edhe unë u detyrova që ta la vajzën time nën kujdesin e nënës time edhe motrave të mija edhe të shkoj në fshatin Budakovë ka qenë, fshati Budakovë. Isha me profesor Shalën, me ni plak të pajtimit, pajtimtar i kohës, Qamil i fshatit Reqan mbiemrin nuk ia di. Na e thirrnim plaku Qamil në atë kohë. Shkum në atë familjen që ishte në gjak me familjen tjetër dhe që duhej ta falte gjakun.

Më kujtohet, ishte natë, nuk kishte drita, nuk kishte as në fshat drita. Udhëtuam ne me atë traktorin deri te ajo familje atje ku duhej të shkonim. Ishte plot oda burra, unë isha dhe dy vajza kanë qenë ma të reja se une. Isha tepër e lumtur, u ndjeva shumë e privilegjuar edhe pse shkonim për ni akt shumë të lartë njerëzor aty për të bërë pajtimin e dy familjeve që të mos vazhdoj hasmëria me familjet. Kur shkuam tek... edhe na e dhanë faljen e gjakut kta. U dashtë ni copë rrugë me bo me atë traktorin, sepse ai fshati ishte lagje, lagje. Ni lagje ishte kështu, mas dhetë minuta rrugëtim duhej të shkonim te lagja tjetër.

Më kujtohet e mora fjalën edhe fola në atë, në atë tubim ku ishim edhe thashë, edhe tregova që jam vajzë, nënë e një vajze ni vjeçare. Thashë, “Për hir të kësaj pajtueshmërie, të faljes së gjakut, të këtij gjaku”, thashë, “unë e kam lanë vajzën time”, thashë, “që është dashtë unë të jem në kontakt me vajzën time për disa orë e kam sakrifikue”, se ajo duhej të ushqejej nga gjiu im, “edhe e sakrifikova gjithë ata për të ardhë këtu edhe për të pajtuar gjaqet” dhe pikërisht, jo, ndoshta unë nuk e kam bërë ndikimin qind për qind aty sepse kanë folë të gjithë ata të tjerët që ishin me neve së bashku. Por, gjëja më kryesore që ishte ne e morëm pajtimin e gjakut dhe shkuam atje te familja tjetër. I njoftum ata edhe ishte një entuziazëm shumë i mirë, ishim të gëzueshëm të gjithë. U krye ajo punë me sukses.

Anita Susuri: Gjatë viteve të ‘90-a a keni qenë edhe ju nëpër shtëpi-shkolla t’u dhonë mësim apo si jeni angazhu? Apo keni shku...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Jo, unë para se me shku tek shtëpitë shkolla, sepse kur osht’, kur janë mbyllë shkollat tona ktu ka qenë niherë ky paralelizmi, sepse i ndajtën nxënësit shqiptarë nga nxënësit serbë. Tash e bonën paradite të shkonin nxënësit serbë në shkolla, masdite ua lanë shqiptarëve. Tash nuk e di saktësisht sa ka zgjatë ajo. Para se me ra në shtëpitë shkolla, na marrim vendim me bashkëshortin që të shkonim në mërgim, sepse atëherë punohej pa të ardhura dhe ishte ni vit e ca ma tepër para se të migronim, punuam pa rroga, nuk kishte rroga në atë kohë.

Unë kisha dy vajza, isha shtatzanë në femiun e tretë dhe nuk kisha alternativë tjetër. Sepse përveç vështirësive ekonomike, unë kisha edhe ni problem shëndetësor që duhej patjetër ta siguroja ni injeksion mas lindjes për ta marrur. Ktu nuk sigurohej në Kosovë, atëherë ishte katastrofë situata në mjekësi. U dashtë të marrim vendim që të linim përjashtë dhe në vitin ‘92 shkuam jashtë. Isha pak para lindjes. Mas 20 dite që kam shku në Suedi ka lindë djali, Mërgimi, femiju ynë i tretë. U dashtë tash të sistemohemi, të involvohemi në sistemin e ni shteti krejt të ri për mua dhe kështu vazhdoi jeta atje.

Anita Susuri: A keni qenë edhe gjatë luftës atje?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, kom qenë gjatë luftës atje. Kemi qenë, kemi qenë aktivë shumë me mbledhjen e fillimisht të tre përqindshit pastaj me mbledhjen të, “Vendlindja thërret”, që bëhej. Shqiptartë në Suedi ju kanë përgjigjë masovikisht thirrjeve të atdheut dhe është bërë ni kontribut i jashtëzakonshëm. Ne vërtetë në luftë nuk kemi qenë në mënyrë fizike, po në mënyrë psiqike më besoni se kemi qenë jashtëzakonisht të rënduar si komunitet shqiptarë. Sepse e dinim të gjithë ne kishim familjet tona këtu dhe e dinim të lufta nuk binte, nuk sillte gjëra të mira.

Shumë herë e kemi kaluar ditë të tëra para televizioneve duke dëgju lajme nga televizoret nga më të ndryshmet. Edhe pse s’e kuptonim anglishten, s’e kuptonim gjermanishen, s’i kuptonim këto gjuhë, vetëm insertët që shihnim mos po takojmë ndonjë familjarë tonin, mos po i shohim ndonjë të njohur tonin. Sepse edhe komunikimi me telefonin nuk mundësohej atëherë. Ishte ni situatë kaotike, ishte ni vështirësi shumë e madhe. Ne kemi qenë shumë në siklet.

Anita Susuri: Familjartë e ju, për shembull, prindërit kanë qenë atëherë gjallë...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Kanë qenë.

Anita Susuri: Ku?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, kanë qenë në Suharekë. Fillimisht kanë qenë në Suharekë, pastaj njëra nga motrat e mija, fatkeqësisht ajo nuk jeton ma, ka qenë, nuk ka arritë me depërtu në Shqipni. Tërë luftën e ka kalu ktu në Kosovë duke u strehua prej ni fshati në fshat tjetër. Ka përgatitë ushqime për ushtartë e Ushtrisë Çlirimtare [të Kosovës], domethonë e ka kalu krejt kohën me djalin e vet edhe bashkëshortin nëpër, nëpër fshatra, nëpër strehimore të ndryshme që kanë ekzistru në atë kohë në Kosovë. Kurse familja tjetër, motra tjetër me familjen e vet, prindërit e mi, vllazërit, nuset, fëmijtë e vllazërve të gjithë janë kanë, kanë arritë me kalu mas ni kohe në Shqipëri.

Kjo motra ime që ka nejt ktu tanë kohën, domethonë në Kosovë, ajo masanej ka tregu historira nga më të ndryshmet. Si janë bartë popullata prej ni vendi në vendin tjetër, ato sakrificat, kështu me radhë. Në kohën kur familjartë e mi para se me dalë në Shqipëri, kur i ka dëbu policia serbe nga shtëpitë në sheshin e Suharekës i ka rreshtue, i kanë nda burrat nga gratë. Burrat i ka qit, tashti i ka bo rend për pushkatim. Në mesin e burrave ka qenë edhe djali i vëllaut tim. Ka qenë i mitur, dymdhetë vjeçar ka qenë me sa kujtoj unë. Fillimisht e kanë ndalë edhe ata edhe vllai... ka qenë fëmija i vetëm i vllaut ai. Ka qëllu ni polic, tash a ka qenë suharekas a s’ka qenë nuk e di kështu saktësisht, mirëpo tregonin vëllazërit që i kanë thanë, njëri prej atyre i ka thanë, “Ky është fmi, le t’shkoj ky me gratë sepse ky është fëmijë”, a din. Tregojnë vllazërit, “Kur e kanë largu Bardhin”, Bardh emrin, “kur e kanë largu Bardhin nga rreshtimi aty ku na rreshtuan për të na ekzekutuar e ndinim vetën aq të lehtësuar, sepes bile dikush nga meshkujt po mbijeton”.

Mirëpo e kanë pasë fatin e mirë se në qat... ndërkohë kur i kanë qitë ata para ekzekutimit, ka ardhë ni dikush edhe ka dhanë urdhër që të gjithë duhej të zhvendosen nga këtu dhe të marrin rrugën për Shqipëri. Këta pastaj e kanë pasë ni kamion, kanë marrë kamionin edhe janë nisë drejt për Shqipëri. Kur kanë dalë në Shqipëri, e kanë pasë numrin tim të telefonit atje në Suedi. Dhe më besoni kur më kanë telefonue, kur janë lajmëruë që kanë shku atje dhe janë shnosh e mirë, unë s'e di, osht' ni ndjenjë aq e gëzueshme, aq e dhimbshme, aq e rëndë, aq sa s'e kom ditë as vet s'i kam folë me ata, si kam bisedua. M'u ka dokë si osht', ka fillu ni jetë nga e para, nga fillimi.

Për këtë motrën këtu në Kosovë që mbetë ni kohë të gjatë, nuk e kemi ditë a është gjallë apo s'është gjallë. Mirëpo, ajo edhe ka gatu, ka gatu për Ushtrinë Çlirimtare edhe pas ni kohe me telefonin që janë shërby ushtartë e UÇK-së ka arritë, domethonë me mu lajmëru mue edhe me më thanë që jom shnosh e mirë, që jam gjallë. Nuk ka guxu me potencu në çfarë vendi jom kështu, mirëpo mjaftueshëm për mu që e kam marrë vesh që ajo jeton. I kom lajmëru mandej edhe familjartë e mi që osht' gjallë, jeton edhe deri në përfundim të luftës jemi marrë vesh, domethonë në qisi mënyra.

Anita Susuri: Qysh ke, sigurisht prej mediave e keni kuptu që ka përfundu lufta. Qysh ke qajo ndjenjë?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po. Unë, në atë kohë isha në ni kurs, shkoja në shkollë atje në Suedi edhe ishte tash ajo dilema apo bie NATO apo s'po i bije. Herë mirrej vendim që t'i binte NATO Jugosllavisë, herë jo. Ne shqiptartë që ishim aty, t'u bisedu ato variantat tona si do të bëhet, çka do të bëhet, kur e kuptuam nga mjetet e informimit që, domethonë veç i ra NATO bazave ushtarake serbe. Atëherë e kemi ndi vetën të rilindur edhe niherë sërish. Natyrisht se ka qenë ni knaqësi e jashtëzakonshme. U mundojshim ne pastaj nëpër çdo emision televiziv t'i merrnim ato insertet, i inçizonim me ato kasetat tona që t'i ruanim, që t'i kemi pastaj për fmitë tanë, për pasardhësit tanë. Ishte ni gjendje jashtëzakonisht e mirë.

Krijonim atje pastaj aktivitete të ndryshme, koncerte, gjëra të ndryshme, se edhe neve na është dashtë ni relaks psikik. Ne kemi qenë jashtëzakonisht, siç thashë të ngarkuar psikikisht se e kishe atë pjesën tjetër të shpirtit tonë, familjet tona në atdhe dhe e dinim se si ishte gjendja ktu. Ni gjendje kaotike, ni gjendje e randë shumë. Ajo ishte... kur erdh liria pastaj, secili nga gyrbeti mundoheshim të vinin ta shihnim Kosovën qysh osht' ktu Kosova...

Anita Susuri: Qato deshta me ju pytë...

Zyrafete Kryeziu Manaj: Kur kemi ardhë ka qenë ni kaos i madh, rrugtë me gropa (qeshë). Erdhëm na deri në Maqedoni me aeroplan edhe vëllau im i vogël kishte dalë me marrë motrën time që vinte nga Gjermania. Unë nuk e dija që vinte motra nga Gjermania dhe... në fakt gabova, ne erdhëm me veturë nga Suedia por ramë nëpër Maqedoni se qashtu ishte itinerari i kohës edhe i rrugëve që duhej të vinim

në Greqi, prej Greqisë të vinim në Maqedoni, prej Maqedonisë në Kosovë. Ka qenë ni rrugë shumë e gjatë.

Vllau i vogël, fmitë e takun atë dhe e përqaftun dhe u çmallën me të. Po na thotë ai, “Keni kujdes”, po i thotë bashkëshortit në qafë, “Ki kujdes me veturë, mos hec shpejt sepse osht’ rruga pak e keqe”, ai po na thotë neve, a po e din. Ne jse na fillim për me ardhë në Kosovë, ajo le që ish kanë e keqe po ish kanë super e keqe (qeshë). Se çdo metër ni gropë dilke knej, njo tjetër knej. Atina, ai e runte makinën se me të njejtën makinë i duhej të ktheheshim. I bonëm na prej, domethonë kufirit të Maqedonisë deri në Suharekë nja pesë orë, kujtoj une. Rruga e mundimshme.

Kur erdhëm ktu u përqaftun me familjartë e me fmitë masandej. Ishin shumë të entuziazmuar. Ishte ni pushim i mrekullueshëm që e kishim bo. Se tash na vijmë, shumë shpesh vijmë. Sidomos unë edhe bashkëshorti tash jemi në pushim edhe vijmë disa herë brenda vitit. Mirëpo, nuk e kemi atë nostalgjinë e mbas luftës, sikur ajo që ishte e mbas luftës. Ka qenë skamje, ka pasë varfëri, ka pasë... jetë e zorshme në atë kohë, mirëpo knaqësia u konë superlative. Tash pak ka ndryshua situata, nuk është ajo gjendja sikur e atëherëshme.

Anita Susuri: Ju pastaj jeni adaptu me jetën në Suedi edhe punoni atje tash?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Unë tash jom penzionere, kom dalë në penzion pak para kohe, ni vit e gjysë para kohe, kom probleme shëndetësore. Në Suedi kom bo punë nga më të ndryshmet. Fillimisht më është dashtë të kyçemi në sistemin e shtetit suedez. Për nja tri vite kemi qenë të pa punë, sepse na është dashtë ta prisnim, ta merrnim lejeqëndrimin në Suedi. Gjatë këtij intervali kohor, në atë vendin e azilit ku ne pritnim ta merrnim, domethonë të merrnim lejeqëndrimin suedez kemi qenë diku nja 40 familje shqiptare. E shihja që kishte nxansë të gjeneratave të ndryshme që e kishin lanë shkollën ktu në Kosovë dhe kanë ardhë në Suedi.

Ni ditë bashkëshorti në bashkëbisedim me vendasit tanë atje kishin marrë vendim që të bonin diçka, të hapnin ni shkollë shqipe s’paku për qat’ kohën sa qëndronim aty. Fmitë t’i grumbullojmë në nji pikë qëndrimi se s’kishin fmitë aktivitete, rrinin nëpër rrugë. Nëpër atë oborrin atje ku ishte ato shtëpijat e azilit, se ishte kamp i madh në qytetin e Degerfors. Vjen bashkëshorti ni mbrëmje thotë, “Do të ishte shumë mirë”, thotë, “të angazhoheshim për shkollën shqipe, të hapnim ni shkollë shqipe”. Unë e kisha djalin, djali im ishte i posalindur dy-tre muj, mirëpo unë aq me vullnet dhe me aq e prita në mënyrë të këndshme atë kërkesën e tij edhe meniherë u tregova e gatshme të punoj me fmitë shqiptarë.

Ai e paraqiti atë te institucionet suedeze, kërkesën tonë. Ata e miratuan meniherë, na siguruan lokalin, lapsa, letra, fleta, libra nga më të ndryshmet edhe ne e lajmërum LASH-in, sepse edhe LASH-i ka qenë funksional edhe në Suedi. Pastaj, në atë kohë u themelue. I hapëm dy klasa me nxanës shqiptarë. Bashkëshorti i mori ata nxënësit ma të mdhaj deri në klasën e pestë, unë i mora kta pak ma të vogël

nga e katërta. Për tri vjet kemi punu me nxanës shqiptarë pa kompenzime, pa rroga, pa të holla, pa kurgjo.

Pastaj, kur e kemi marrë lejën e qëndrimit u dashtë të shpërnguleshim në ni komunë tjetër edhe u shpërngulëm. Nuk kom mujtë të kyçem meniherë në sistemin arsimor. Kom punu disa vite në ni fabrikë ku prodhoheshin pjesët e veturave, Volvo ose Skania si këto. Pastaj, u lirue vendi i punës në, në Vetlandë, jo aty ku jetoja. Ni qytet e kena pasë nja 22-23 kilometra edhe punoja aty si msuse e gjuhës shqipe me fëmitë shqiptarë, po edhe asistojta në klasët suedeze ku kishte fmi shqiptarë. Kom punu disa vite aty dhe shkollimi, domethonë, rregullativa e mësimit shqip në shtetin e Suedisë është e rregulluar me sistemin e shkollave suedeze.

Mësimdhënësit atje paguhen sikurse paguhen mësimdhënësit që punojnë në shkollën e rregullt suedeze edhe shqiptarët. Janë të involvuar në procesin mësimor të përgjithshëm dhe mësimdhënësit notohen atje, marrin poena nga gjuha shqipe edhe domethonë, ata nxënës që e ndjekin gjuhën shqipe kur notohet normal që iu ngritet edhe poenat e përgjithshme të klasës. Kështu që, është e rregullume mirë sistemi i shkollimit të gjuhës shqipe në Suedi. Edhe nxënësit i përgjigjen masovikisht shkollës shqipe.

Çka osht' për t'u theksuar, ndoshta këto gjeneratat e tona që kemi shku atje, ne domosdoshmërisht që e kemi ditë rëndësinë e shkollës shqipe. Mirëpo, osht' për t'u përshëndetur që fmitë tanë, për shembull, unë i kom dy vajza të martuar dhe i kam katër nipër, dhe gjeneratat e fmive tonë e kanë kuptuar shumë seriozisht rëndësinë e mësimit të gjuhës shqipe dhe i përgjigjen edhe fmitë të tyre domethonë, i përgjigjen shkollës shqipe dhe shkojnë masovikisht në shkollën shqipe.

Anita Susuri: A osht' komunitet i madh shqiptar?

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, osht' komunitet i madh. Ka, tashti nuk e di saktësisht numrin, por po them se nuk ka komunë në Suedi që të mos ketë familje shqiptare. Kurse rregullativa e ndjekjes së mësimit të gjuhës shqipe është e rregulluar, nëse mrena ni shkollës ka vetëm pesë nxanës që flasin shqip ju mundësohet të ndjekin shkollën shqipe aty, vetëm pesë nxanës. E gati, nuk ka shkollë që nuk ka pesë nxanës shqiptarë që e ndjekin shkollën aty.

Masanej, unë ni kohë kom punu edhe, pas mësimit të gjuhës shqipe, se kom pasë probleme shëndetësore dhe e kom ndërpre punën. Mas ni rehabilitimi që e kom bo në fizik, kom punu në shkollën suedeze, ku nxënësit suedeze përfundojnë shkollën gjatë ditës dhe prindërit e tyre punojnë deri në kohën... kur prindërit e tyre punojnë ata nga shkolla vijnë në aktivitete të lira në shkollë aty. Unë kom punu aty me nxënës suedeze, e shqiptarë e nacionalitete tjera, por me personalitet suedez.

Është... kisha dashtë shumë, kisha dashtë punëtortë e parashkollorëve që punojnë këtu në Suedi të klasëve të ulëta që punojnë këtu në Kosovë e kom fjalën që të bëjnë trajnime në shtetin suedez dhe ta

shohin se nga parashkollorët, nga ato ciklet e ulëta të shkollimit brumoset fëmiju me kulturën sesi duhet të ruhet ambienti, sesi duhet të bëhej sjellja në shoqëri, sesi duhej respektohet familja e shumë gjëra të tjera. Që pastaj nga mosha madhore aty fillon të merr, nxënësi i rritur ta fitojë konceptin personal që ai tash është i rritun, ai din si duhej vepruar. Kto janë nga mosha e njomë mbillen shumë gjëra që i duhen shoqërisë kosovare.

Anita Susuri: Ju edhe keni shkru, disa libra i keni publiku.

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po.

Anita Susuri: Jeni marrë me shkrime.

Zyrafete Kryeziu Manaj: Po, unë mirrem edhe me shkrime. Merrem qysh herët me shkrime, por me të thanë të drejtën librin tim të parë e kom botue fill mas luftës së Kosovës në vitin 1999. Më asht' mundësua, e kam botuar në Shqipëri në shtypshkronjën "Dritëro", që e udhëheqke vajza e Dritëro Agollit atje. Kur e kam botua, nuk i kam unë të gjitha ekzemplartë se janë shpërnda, e disa i gjeta ktu po disa nuk i kam. Jam ndje jashtëzakonisht mirë kur e kom botu librin e parë. M'u ka dokë sikur ka lindë fmija im i parë, a din (buzëqeshë). E kam përjetuar në atë mënyrë.

Në vazhdimësi pastaj, çdo, kur osht' përmbushë materiali për ta botuar materialin e parë e të dytin e kështu me radhë. Tash së fundmi i kam botua kto dy libra, osht' ni "Hieroglifët e shpirtit në trajtat e kohës" dhe është me tregime, ese, trajtesa edhe intervista. Ni pjesë dërmuese e këtij libri bën fjalë për shoqet e mija, bashkëvuajtëse të dënimeve nëpër burgjet e Kosovës dhe jo vetëm të Kosovës. Pastaj... kryesisht flet për gratë dhe vajzat shqiptare. Flet për, është ni tregim që flet për ni nanë se si i ka humbë familjen e vet, tërë familjen e vet në Kosovë dhe emigron në Suedi. Qysh flet me vetën e saj kur shkon postieri suedez ia lshon postën në banesën e saj dhe i doket ai postieri që është djali i saj.

Ni nanë tjetër shqiptare i afrohet aty afër dhe e pytë, thotë, "Çka po flet me vetëvetën?" Edhe fillon ajo me i rrëfy tregimin se si vjen ai postieri, ai i duket që është djali i saj e si dëshiron që trikon, gjamperin që ia ka maru dajlit të saj t'ia japë atij postieri. Sepse në brendinë e trurit të saj ajo vinte si djali i saj, jo si ni postier, po si djali i saj. Ajo fliste me vetëvetën dhe thonte ky është djali im, ky i ka të gjitha tiparet e djalit tim dhe s'ka si të mos jetë djali im. Po veç gjuhën nuk e ka të djalit tim, sepse ai flet në gjuhen suedeze. Dhe disa tregime tjera domethonë.

Shumë e kisha preferu që lexuesit... ky libër gjindet në librarinë, "Artini", aty te Instituti Albanologjik, aty osht'. I kom lanë disa ekzemplarë të mi, të dy ktyne librave të fundit edhe kush është i interesuar mund t'i gjejë atje. Po vazhdoj me, unë tash edhe si penzionere kom kohë pak ma tepër të merrem. E kam në dorëshkrim ni roman, aty flet mbi luftën dhe dashurinë aty, dashurinë e dy të rive se si i ndan lufta. S'po zbërthej sekuenca ma asi. Mendoj ta lë pak si surprizë për lexuesin kur do të vijë romani. Kështu po e vazhdoj jetën, pak në Kosovë pak ma shumë në Suedi se s'un po shkëputen prej atyne

nipërave t'mi (qeshë) e familjes time. Por, megjithatë i kemi rrugët pak ma të shpeshta tash për në atdhe.

Anita Susuri: Zonja Zyrafete, nëse keni edhe diçka që doni për fund me shtu.

Zyrafete Kryeziu Manaj: Unë ju falënderoj juve për gjithë këtë bashkëbisedim që e bëmë së bashku. Isha shumë e knaqur dhe e lumtur që e bëmë këtë bisedë bashkë. Për fund do të doja që rinisë të Kosovës t'i thoja, sepse e shof që kohëve të fundit mërgata ose mërgimi, mërgimi sidomos është bërë si ni çelës, si ni çelës për të hapë rrugë të reja, për të ritë edhe ni pjesë e popullatës që ta lë Kosovën dhe të mërgoj.

Mërgimi nuk është kafshatë e lehtë për t'u kapërdirë, është kafshatë e rëndë. Unë po them se kurrë ma mirë se sot Kosova nuk e ka pasë gjendjen për të bërë diçka edhe më të mirë për të. Por kush mund të bëjë ma të mirën për Kosovën, rinia e Kosovës, njerëzit e saj. Sepse perëndimi mund të na ndihmojë, Evropa mund të na ndihmojë, por në duar tona ne e kemi fatin tonë. Andaj përqëndrohuni që të jetojmë dhe të veprojmë dhe të kontribuojmë në atdheun tonë. E këtë do të doja të thoja për të gjithë ata që mendojnë e synojnë të shkojnë në mërgim.

Anita Susuri: Faleminderit shumë!

Zyrafete Kryeziu Manaj: Faleminderit juve që ishit me mua.